

**Propozimi gjithëpërfshirës
për zgjidhjen e statusit të Kosovës**

26 mars 2007

Përmbajtja

Dispozitat e përgjithshme	2
Aneksi I – Dispozitat kushtetuese	12
Aneksi II – Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të komuniteteve	19
Aneksi III – Decentralizimi	23
Shtojcë Aneksit III – Përcaktimi i komunave të reja	33
Aneksi IV – Sistemi gjyqësor	35
Aneksi V – Trashëgimia fetare dhe kulturore	39
Aneksi VI – Borxhi i jashtëm	45
Aneksi VII – Prona dhe arkivi	46
Aneksi VIII – Sektori i sigurisë së Kosovës	50
Aneksi IX – Përfaqësuesi civil ndërkombëtar	53
Aneksi X – Misioni evropian për politika të sigurisë dhe mbrojtjes	58
Aneksi XI – Prania ushtarake ndërkombëtare	59
Aneksi XII – Agjenda legjislative	62

PROPOZIMI GJITHËPËRFSHIRËS PËR ZGJIDHJEN E STATUSIT TË KOSOVËS

Neni 1 Dispozitat e përgjithshme

1.1 Kosova do të jetë shoqëri shumëetnike, që do të qeveriset në mënyrë demokratike dhe me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

1.2 Ushtrimi i pushtetit publik në Kosovë do të bazohet në barazinë e të gjithë qytetarëve dhe respektimin e nivelit më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

1.3 Kosova do të miratojë Kushtetutën. Kushtetuta e Kosovës do të përshkruajë dhe garantojë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë, të cilët janë të domosdoshëm për t'u siguruar se Kosova qeveriset sipas standardeve më të larta demokratike, dhe e cila do të promovojë bashkëjetesën paqësore dhe prosperitetin e të gjithë banorëve të saj. Kushtetuta do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në parimet dhe dispozitat e përfshira në Aneksin I të kësaj zgjidhjeje.

1.4 Kosova do të ketë ekonomi të hapur të tregut me konkurrencë të lirë.

1.5 Kosova do të gëzojë të drejtën e negociimit dhe lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të drejtën për të kërkuar anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

1.6 Gjuhë zyrtare në Kosovë do të jenë gjuha shqipe dhe serbe. Gjuha turke, boshnjake dhe ajo romë do të kenë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal apo do të jenë në përdorim zyrtar në pajtim me ligjin.

1.7 Kosova do të ketë simbolet e veta të veçanta nacionale, duke përfshirë flamurin, stemën dhe himnin, të cilët pasqyrojnë karakterin e saj shumëetnik.

1.8 Kosova nuk do të ketë pretendime territoriale ndaj asnjë shteti apo pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë bashkim me asnjë shtet apo pjesë të ndonjë shteti.

1.9 Kosova do të bashkëpunojë plotësisht me të gjitha entitetet e përfshira në implementimin e kësaj zgjidhjeje dhe do të ndërmarrë të gjitha obligimet që parashihen për të me këtë zgjidhje. Kosova dhe Republika e Serbisë inkurajohen të bashkëpunojnë në mirëbesim sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me implementimin dhe realizimin e kushteve të kësaj zgjidhjeje.

1.10 Kosova dhe Republika e Serbisë inkurajohen që të themelojnë një komision të përbashkët për të mundësuar bashkëpunimin e tillë, si dhe për të ushtruar dhe zhvilluar marrëdhënie të mira fqinjësore.

1.11 Komuniteti ndërkombëtar do të kontrollojë, mbikëqyrë dhe do të ketë tërë pushtetin e domosdoshëm për të siguruar implementimin efektiv dhe efikas të kësaj zgjidhjeje, sipas përkufizimeve të ofruara në Aneksin IX, X, XI. Kosova gjithashtu do të ftojë bashkësinë ndërkombëtare që t'i ndihmojë Kosovës në përmbushjen e suksesshme të obligimeve saja.

Neni 2 Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut

2.1 Kosova do të promovojë, mbrojtë dhe respektojë nivelin më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj. Kosova do të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme drejt ratifikimit të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve saj.

2.2 Të gjithë njerëzit e Kosovës kanë të drejtë të gëzojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, pa diskriminim të çfarëdo lloji në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike apo mendimeve të tjera, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, lindjes apo statusi tjetër. Të gjithë njerëzit në Kosovë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë, pa diskriminim, në mbrojtje të barabartë ligjore.

2.3 Parimet e mosdiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë para ligjit do të zbatohen dhe respektohen, posaçërisht në fushat e punësimit në administratën publike, në ndërmarrjet publike dhe qasjen në financa publike.

2.4 Kushtetuta e Kosovës do të përshkruajë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë për mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut për të gjithë njerëzit e Kosovës, siç përcaktohet në Aneksin I të kësaj zgjidhjeje.

2.5 Kosova do të promovojë dhe respektojë në tërësi procesin e pajtimit në mes të të gjitha komuniteteve të saj dhe pjesëtarëve të tyre. Kosova do të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse, me ndjeshmëri gjinore, për t'u ballafaquar me të kaluarën e saj, e cila do të përfshijë një varg të gjerë iniciativash kalimtare të drejtësisë.

2.6 Të gjitha autoritetet kompetente në Kosovë do të bashkëpunojnë me mekanizmat apo organizatat e pranuar ndërkombëtarisht për monitorimin e të drejtave të njeriut, dhe atyre do t'u ofrojnë qasje të papenguar.

Neni 3 Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre

3.1 Banorët që i përkasin të njëjtit grup kombëtar apo etnik, gjuhësor, apo grupi fetar tradicionalisht i pranishëm në territorin e Kosovës (më tej komunitete) do të kenë të drejta të veçanta, të përcaktuara në Aneksin II të kësaj zgjidhjeje, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në nenin 2 të Aneksit I të kësaj zgjidhjeje.

3.2 Kosova do të garantojë mbrojtjen e identitetit kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Kosova do të krijojë mekanizma kushtetues, ligjorë dhe institucionalë të nevojshëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve dhe për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse, siç përcaktohet në Aneksin I dhe II të kësaj zgjidhjeje.

3.3 Autoritetet e Kosovës do të udhëhiqen në politikat dhe praktikat e tyre nga nevoja për të promovuar frymë të paqes, tolerancës dhe dialogut ndërkulturor dhe ndërfetar mes komuniteteve saj dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 4 Të drejtat e refugjatëve dhe të personave të zhvendosur

4.1 Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit nga Kosova do të kenë të drejtën e kthimit dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Çdo person do të ketë të drejtë të merr vendim të lirë dhe të jetë i informuar për vendin ku ai kthehet.

4.2 Kosova do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar dhe krijuar një atmosferë të favorshme për kthim të sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe të bazuara në informata të sakta, përfshirë përpjekjet për të promovuar dhe mbrojtur lirinë e tyre të lëvizjes dhe mbrojtjen nga kërcënimi.

4.3 Kosova do të bashkëpunojë plotësisht me Komesarin e Lartë për të Drejta të Refugjatëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili do t'i ndihmojë autoritetet kompetente në ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës për të kthyerit, dhe i cili, mes tjerash, do të kryejë vlerësime periodike dhe do të ofrojë raporte publike mbi kushtet e kthimit dhe gjendjen e personave të zhvendosur brenda Kosovës, dhe gjithashtu do të ofrojë bashkëpunimin me organizata të tjera të përfshira në procesin e kthimit.

Neni 5 Personat e zhdukur

5.1 Kosova dhe Republika e Serbisë, në pajtim me normat dhe standardet vendore dhe ndërkombëtare, do të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të përcaktuar dhe ofruar

informata sa i përket identitetit, vendndodhjes dhe fatit të personave të zhdukur, në bashkëpunim të plotë me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) dhe partnerët tjerë relevantë ndërkombëtarë.

5.2 Kosova dhe Republika e Serbisë do të vazhdojnë të marrin pjesë në mënyrë kuptimplotë, efektive dhe pa vonesa të panevojshme në Grupin punues për persona të zhdukur, të themeluar sipas kornizës së “Dialogut të Vjenës” dhe të kryesuar nga KNKK-ja apo ndonjë mekanizmi tjetër pasardhës i cili mund të themelohet. Kryesuesi i Grupit punues do të publikojë raporte periodike publike lidhur me përparimin e Grupit punues. Kosova dhe Republika e Serbisë do të fuqizojnë institucionet përkatëse qeveritare të ngarkuara me këtë çështje me mandat ligjor, autoritet dhe resurse të nevojshme për të mbajtur dhe intensifikuar këtë dialog, dhe për të siguruar bashkëpunim aktiv të të gjitha administratave gjegjëse.

Neni 6 Vetëqeverisja lokale dhe decentralizimi

6.1 Komunat do të jenë njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

6.2 Vetëqeverisja lokale në Kosovë do të bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit gjatë ofrimit të shërbimeve publike, duke i kushtuar kujdes të posaçëm nevojave dhe brengave të komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe pjesëtarëve të tyre.

6.3 Komunat në Kosovë do kenë të drejtë për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar në çështjet me interes të përbashkët gjatë ushtrimit të përgjegjësisë së tyre, siç parashihet në Aneksin III të kësaj zgjidhjeje.

6.4 Kufijtë e komunave të reja do të përcaktohen në pajtim me Shtojcën e Aneksit III të kësaj zgjidhjeje.

Neni 7 Trashëgimia fetare dhe kulturore

7.1 Kosova do të sigurojë autonominë dhe mbrojtjen e të gjitha konfesioneve fetare dhe tërësisë së objekteve fetare brenda territorit të saj.

7.2 Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë (KOS), duke përfshirë klerin dhe pjesëtarët, aktivitetet dhe pronave të saj, do t’u ofrohet siguri shtesë dhe masa tjera mbrojtëse për gëzimin e plotë të të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve të tyre, siç parashihet me Aneksin V të kësaj zgjidhjeje.

7.3 KOS do të jetë e pronarja e vetme e pronës së saj në Kosovë, me diskrecion të plotë sa i përket menaxhimit të pronës së saj dhe qasjes në anekset përreth, siç parashihet me Aneksin V të kësaj zgjidhjeje.

7.4 Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) do të themelojë Këshillin Zbatues dhe Mbikëqyrës (KZM), i cili do të mbikëqyrë dhe ndihmojë zbatimin e plotë të dispozitave dhe masave mbrojtëse të posaçme të cilat i ofrohen KOS dhe lokacioneve fetare e kulturore serbe, siç parashihet me Aneksin V të kësaj zgjidhjeje.

Neni 8 Çështjet ekonomike dhe pronësore

8.1 Kosova do të zbatojë politika ekonomike, sociale dhe fiskale të domosdoshme për një ekonomi të qëndrueshme. Për të përkrahur veçanërisht sistemin e qëndrueshëm të llogarive publike, Kosova do të themelojë një sistem të mbikëqyrjes fiskale, me Komisionin Evropian dhe në bashkëpunim të ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Gjatë përgatitjes së buxhetit të saj Kosova do të këshillohet me PCN-në.

8.2 Çdo borxh i jashtëm i Republikës së Serbisë, i cili i ngarkohet Kosovës, si rezultat i procesit të alokimit të borxheve, siç parashihet me Aneksin VI të kësaj zgjidhjeje, do të konsiderohet detyrim financiar i Kosovës.

8.3 Prona e luajtshme dhe e paluajtshme e Republikës Federative të Jugosllavisë apo e Republikës së Serbisë, e cila ndodhet brenda territorit të Kosovës në momentin e zgjidhjes, do t'i kalohet në pronësi Kosovës.

8.4 Ndërmarrjet publike dhe obligimet e ndërlidhura me to, dhe ndërmarrjet shoqërore dhe asetet e tyre, aktualisht nën jurisdikcion të Agjensionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM), do të rregullohen siç parashihet me Aneksin VII të kësaj Marrëveshjeje.

8.5 Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) do të vazhdojë të mbajë në trust asetet private për pensione, dhe ato asetet do t'i investojë në mënyrë të matur. Funksionet e veta do t'i kryej në mënyrë të pavarur. Bordi drejtues i TKPK-së do t'i kryej detyrat e veta fiduciare vetëm në interesin e përfituesve të tij.

8.6 Kosova do të njohë, mbrojë dhe fuqizojë ushtrimin e drejtave të personave mbi pronat e tyre private të luajtshme dhe të paluajtshme në Kosovë, në pajtim me norma dhe standarde të njohura ndërkombëtarisht. Kërkesat lidhur me pronat private të paluajtshme, duke përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale, sipas nevojës, do të vazhdojnë të trajtohen nga Agjencioni Kosovar i Pronave (AKP) siç parashihet me Aneksin VII të kësaj zgjidhjeje. Kosova do t'i trajtojë me prioritet të gjitha çështjet e kthimit të pronave, përfshirë ato të Kishës Ortodokse Serbe, siç parashihet me Aneksin VII të kësaj zgjidhjeje.

8.7 Kosova dhe Republika e Serbisë do të zhvillojnë lidhjet ekonomike ndërmjet tyre . Ata gjithashtu do të tentojnë të zgjidhin në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha mosmarrëveshjet në mes tyre të cilat nuk trajtohen nga kjo zgjidhje, me pajtim të dyanshëm, duke marrë parasysh normat dhe standardet relevante ndërkombëtare. Kosova dhe Republika e Serbisë pritet të sigurojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues ndaj

kërkesave pronësore dhe financiare të qytetarëve të njëra tjetrës, dhe do të sigurojnë qasje të barabartë dhe jodiskriminuese në juridiksionet dhe mekanizmat e vet për zgjidhje të kërkesave.

Neni 9 Sektori i sigurisë

9.1 Përveç në rastet e përcaktuara ndryshe me këtë zgjidhje, Kosova do të ketë pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, shërbimet e inteligjencës, reagimin emergjent civil dhe kontrollin e kufijve të territorit të saj.

9.2 Institucionet kosovare të sigurisë do të veprojnë në pajtim me standardet demokratike të njohura ndërkombëtarisht dhe të drejtat e njeriut, dhe do të sigurojë përfaqësim të barabartë proporcional të komuniteteve në të gjitha nivelet e gradimit, në pajtim me nenin 4.4 të Shtojcës II të kësaj zgjidhjeje.

9.3 Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) dhe Prania Ushtarake Ndërkombëtare (PUN), në pajtim me dispozitat e kësaj zgjidhjeje dhe sipas mandateve të tyre gjegjëse, do të mbikëqyrin dhe udhëzojnë zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve kosovare të sigurisë.

9.4 Do të themelohet një forcë e re profesionale dhe shumetnike, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), e cila do të paraqesë një komponentë të armatosur lehtë, e aftë për të kryer funksione specifike të sigurisë, siç parashihet me Aneksin VIII të kësaj zgjidhjeje.

9.5 Kosova do të themelojë një organizatë civile brenda Qeverisë e cila do të ushtrojë kontroll civil mbi FSK-në, në pajtim me këtë zgjidhjeje.

9.6 TMK-ja, pasi të ketë arritur qëllimet e parapara, përfshirë mundësimin e rimëkëmbjes së Kosovës pas konfliktit, do të shpërbëhet një vit pas përfundimit të periudhës kalimtare, të paraparë në nenin 15 të kësaj zgjidhjeje.

9.7 Të gjitha organizatat e paautorizuara me ligj për të kryer veprimtari në sektorin e sigurisë në Kosovë do të pushojnë së vepruari.

Neni 10 Komisioni kushtetues dhe zgjedhjet

10.1 Menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhjeje, Kryetari i Kosovës, në këshillim me Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, do të thërret një Komision kushtetues për hartimin e Kushtetutës, në këshillim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, në pajtim me këtë zgjidhjeje.

10.2 Komisioni kushtetues do të përbëhet nga njëzet e një (21) anëtarë kosovarë, të cilët duhet të kenë kualifikimet relevante profesionale dhe ekspertizën e duhur për arritjen e

këtij qëllimi, dhe i cili do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e shoqërisë së Kosovës, duke marrë parasysh parimet e njohura ndërkombëtarisht të barazisë gjinore, siç parashihet me instrumentet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në nenin 2 të Aneksit I të kësaj zgjidhjeje. Pesëmbëdhjetë (15) anëtarë do të emërohen nga Kryetari i Kosovës në këshillim me Kryesinë e Kuvendit. Tre (3) anëtarë do të emërohen mes deputetëve të Kuvendit që mbajnë ulëset e rezervuara për komunitetin serb në Kosovë, dhe tre (3) anëtarë do të emërohen mes deputetëve të Kuvendit të cilët mbajnë ulëset e rezervuara për komunitetet tjera joshumicë në Kosovë.

10.3 Komisioni do të themelojë një mekanizëm kuptimplotë i cili do të informojë anëtarët dhe opinionin publik mbi punën e vet. PCN-ja do të emërojë përfaqësues të cilët do të ndihmojnë punën e Komisionit, përfshirë hartimin e rregulloreve të punës dhe vlerësimin e modeleve ndërkombëtare për hartimin e Kushtetutës.

10.4 Kuvendi nuk mund të miratojë formalisht Kushtetutën përderisa PCN-ja mos ta vlerësojë se ajo është në pajtim me kushtet e parapara me këtë zgjidhje. Kuvendi do ta miratojë formalisht Kushtetutën brenda 120 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje, me votim të dy të tretave të shumicës së deputetëve aktual të Kuvendit të Kosovës, me dy të tretat e deputetëve të pranishëm që votojnë, pas këshillimeve të duhura me deputetët e Kuvendit që përfaqësojnë komunitetet joshumicë në Kosovë. Pas miratimit formal, Kushtetuta do të vlerësohet si e miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe do të hyjë në fuqi ditën e parë pas kalimit të periudhës kalimtare që parashihet me nenin 14.1 të kësaj zgjidhjeje.

Neni 11 Zgjedhjet

11.1 Jo më vonë se nëntë muaj nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje, Kosova do të organizojë zgjedhje të përgjithshme dhe komunale në pajtim me kushtet e kësaj zgjidhjeje dhe kufijve të ri komunal, të përcaktuar me Aneksin III të kësaj zgjidhjeje. Zgjedhjet do të duhet të certifikohen se i kanë përmbushur standardet ndërkombëtare nga një autoritet kompetent ndërkombëtar.

11.2 Të gjithë personat që e kanë moshën për votim, në ditën përkatëse të zgjedhjeve, të cilët në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhjeje janë regjistruar si banorë të përhershëm, apo ata të cilët banojnë jashtë Kosovës dhe nga Kosova janë larguar më apo pas 1 janarit të vitit 1998, dhe në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhjeje i plotësojnë kriteret për t'u regjistruar si banorë të përhershëm, do të kenë të drejtë të votojnë në këto zgjedhje, në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 12 Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar

12.1 Një Grup Drejtues Ndërkombëtar (GND), i cili do të përbëhet nga akterët kyç ndërkombëtarë, do të emërojë Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN) dhe do të

kërkojnë nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratimin e emërimit. PCN-ja dhe Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE), i emëruar nga Këshilli i Bashkimit Evropian do të jenë i njëjti person.

12.2 GND do të përkrahë dhe do t'i japë udhëzime Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar në përmbushjen e mandatit të tij.

12.3 PCN-ja do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për mbikëqyrjen, dhe do të jetë autoriteti përfundimtar në Kosovë për sa i përket interpretimit të kësaj zgjidhjeje, siç parashihet me Aneksin IX, e veçanërisht nenin 2 të kësaj zgjidhjeje.

12.4 Siç parashihet me Aneksin IX të kësaj zgjidhjeje, PCN-së do t'i besohet ushtrimi i autoriteteve të caktuara për sigurimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të plotë të kësaj zgjidhjeje, përfshirë autoritetin për të ndërmarrë masa, sipas nevojës, për parandalim dhe përmirësimin e shkeljeve të kësaj zgjidhjeje. PCN-së do t'i barten kompetenca edhe në cilësinë e tij si PSBE, siç parashihet me nenin IX të kësaj zgjidhjeje.

12.5 PCN-ja do të ketë rolin e përgjithshëm bashkërendues mbi aktivitetet e organizatave tjera ndërkombëtare në Kosovë përderisa ato ndërlidhen me përgjegjësitë e PCN-së për monitorimin dhe sigurimin e zbatimit të plotë të kësaj zgjidhjeje, siç parashihet në Aneksin IX të saj.

12.6 Mandati i PCN-së do të vazhdohet përderisa Grupi Drejtues Ndërkombëtar të vlerësojë se Kosova ka përmbushur kushtet e parapara me këtë zgjidhje. GND-ja do të ofrojë udhëzime për zvogëlimin deri në tërheqjen përfundimtare të PCN-së.

12.7 GND-ja do të kryejë rishikimin e parë të mandatit të PCN-së, bazuar në gjendjen e zbatimit të kësaj zgjidhjeje jo më vonë se dy vite pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 13 Përkrahja ndërkombëtare në fushën e sundimit të ligjit

13.1 Bashkimi Evropian do të themelojë Misionin Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes (MEPSM).

13.2 MEPSM-ja do t'i ndihmojë autoritetet kosovare në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë dhe në zhvillimin e fuqizimin e mëtejme të gjyqësorit të pavarur, shërbimit policor dhe doganor, duke siguruar se këto institucione veprojnë jashtë ndikimit politik dhe në pajtueshmëri me standardet e pranuar ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

13.3 MEPSM-ja do të përkrahë implementimin e kësaj zgjidhjeje dhe do të ofrojë këshillim, monitorim dhe njoftim në fushën e sundimit të ligjit në përgjithësi, duke mbajtur autoritete të caktuara, në veçanti sa i përket gjyqësorit, shërbimit policor, atij

doganor dhe korrektues, nën modalitetet dhe përgjatë një periudhe kohore të përcaktuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian, në pajtim me Aneksin IX dhe X të kësaj zgjidhjeje.

Neni 14 Prania Ushtarake Ndërkombëtare

14.1 NATO do të krijojë një Prani Ushtarake Ndërkombëtare (PUN) për të përkrahur implementimin e kësaj zgjidhjeje, siç parashihet me Aneksin XI të saj.

14.2 Kjo PUN do të udhëhiqet nga NATO-ja dhe do të veprojë nën autoritetin e Këshillit Veriatlantik dhe do të nënshtrohet udhëzimeve dhe kontrollit politik të tij, përmes zinxhirit komandues të NATO-s. Prania ushtarake e NATO-s në Kosovë nuk parandalon krijimin e një misioni përcjellës në të ardhmen nga ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare të sigurisë, pas rishikimit të mandatit.

14.3 PUN do të bashkëpunojë ngushtë dhe do të përkrahë punën e PCN-së, MEPSM-së dhe organizatave tjera ndërkombëtare që mund të jenë të pranishme në Kosovë, për të mbikëqyrur dhe siguruar zbatimin e plotë të kësaj zgjidhjeje.

14.4 PUN-ja do të jetë përgjegjëse për ofrimin e një mjedisi të sigurt në tërë territorin e Kosovës, në bashkëveprim me PCN-në dhe në përkrahje të institucioneve të Kosovës, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës të jenë në gjendje të marrin përsipër përgjegjësitë, pas shqyrtimit të çdo rasti veçmas, sa i përket detyrave të sigurisë të kryera nga PUN-i. Me kalimin e kohës, Kosova, përkrahur nga PCN-ja dhe PUN-i, do të zhvillojë një proces për të parashtruar një plan të tranzicionit për bartjen e përgjegjësisë të sigurisë së PUN-it.

14.5 PUN do të ketë përgjegjësinë e përgjithshme për zhvillimin dhe trajnimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, dhe NATO-ja do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për zhvillimin dhe themelimin e një organizate civile të Qeverisë për të ushtruar kontroll civil ndaj kësaj Force, pa paragjykim ndaj përgjegjësisë të PCN-së, siç parashihet në Aneksin IX të kësaj zgjidhjeje.

Neni 15 Rregullimet kalimtare dhe dispozitat përfundimtare

15.1 Pas hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhjeje, do të parashihet një periudhë kalimtare prej 120 ditëve:

- a) Gjatë periudhës së tranzicionit, UNMIK-u do të vazhdojë të ushtrojë mandatin e vet në pajtim me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSOKB), në konsultim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN). Gjatë periudhës së tranzicionit, KFOR-i do të vazhdojë të ushtrojë mandatin e tij në pajtim me rezolutat përkatëse të KSOKB-së. PCN-ja do të ketë pushtet për të mbikëqyrur implementimin e zgjidhjes gjatë

periudhës së tranzicionit dhe për t'i rekomanduar UNMIK-ut mbi veprimet që duhet ndërmarrë për të siguruar pajtueshmërinë me këtë zgjidhje.

b) Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme dhe ligjet tjera në fuqi do të mbesin në fuqi deri në përfundim të periudhës së tranzicionit, përderisa nuk bien në kundërshtim me këtë zgjidhje.

c) Kuvendi i Kosovës do të miratojë formalisht Kushtetutën e re para përfundimit të kësaj periudhe të tranzicionit në pajtim me kushtet e kësaj zgjidhjeje.

d) Nëse deri në fund të periudhës së tranzicionit, Kushtetuta e re nuk miratohet formalisht, UNMIK-u do të ndryshojë Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në pajtim me kushtet e kësaj zgjidhjeje. Korniza e ndryshuar Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme do të mbetet në fuqi deri në momentin e miratimit të Kushtetutës së re nga Kuvendi.

e) Gjatë periudhës së tranzicionit, Kuvendi i Kosovës, në këshillim me PCN-në do të miratojë formalisht legjislacionin e nevojshëm, në veçanti siç parashihet me Aneksin XII të kësaj zgjidhjeje për të zbatuar plotësisht kushtet e kësaj zgjidhjeje. Legjislacioni i tillë, i cili nuk kërkon miratimin e mëtejme apo shpalljen nga ana e UNMIK-ut, do të trajtohet si i miratuar formalisht nga Kuvendi i Kosovës dhe do të hyjë në fuqi menjëherë pas përfundimit të periudhës së tranzicionit, nëse është në pajtim me këtë zgjidhje dhe Kushtetutën e re apo Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme të ndryshuar nga UNMIK-u. Deri në hyrjen në fuqi të këtij legjislacioni, autoritetet kompetente në Kosovë do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që nuk merren veprime që janë në kundërshtim me këtë zgjidhje.

f) Gjatë periudhës së tranzicionit, UNMIK-u dhe PCN-ja apo përfaqësuesi i tij, do të bashkëkryesojnë grupet punuese për të formuluar me Kosovën detajet dhe modalitetet për bartjen e kompetencave.

g) Në fund të periudhës së tranzicionit, mandati i UNMIK-ut do të skadojë dhe i tërë pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv që i është veshur UNMIK-ut do të bartet tek autoritetet qeverisëse të Kosovës, përveç nëse me këtë zgjidhje parashihet ndryshe. Në këtë kohë, PCN-ja dhe PUN-ja do të marrin përsipër përgjegjësi të plotë për ushtrimin e mandatit të tyre, siç parashihet në këtë zgjidhje.

h) Gjatë periudhës së tranzicionit, përmes një marrëveshjeje në mes të OKB-së (UNMIK) dhe Kosovës dhe në konsultim me PCN-në, do të vendoset regjimi ligjor që përcakton shpërbërjen e të gjitha përgjegjësive të mbetura të UNMIK-ut.

15.2 Në bashkëpunim të ngushtë me PCN-në, UNMIK-u do të sigurojë kalim të rregullt të kornizës ligjore nga ajo që aktualisht është në fuqi në kornizën ligjore të themeluar përmes kësaj zgjidhjeje.

15.2.1 Rregulloret e UNMIK-ut të shpallura nga PSSP-ja, në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë urdhëresat administrative dhe vendimet ekzekutive të nxjerra nga PSSP-ja dhe ligjet e shpallura të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, do të vazhdojnë së zbatuari, përveç nëse me këtë zgjidhje përcaktohet ndryshe, deri në skadimin e vlefshmërisë së tyre apo deri në anulimin apo zëvendësimin e tyre me legjislacionin që rregullon të njëjtën çështje në pajtim me dispozitat e kësaj zgjidhjeje.

15.2.2 Kosova do të vazhdojë të jetë e obliguar, në baza të reciprocitetit, sipas nevojës, nga të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare dhe rregullimet tjera në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, të nënshkruara nga UNMIK-u për Kosovën dhe në emër saj dhe të cilat janë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhjeje. Obligimet financiare të ndërmarra nga UNMIK-u për Kosovën dhe në emër saj, në pajtim me këto marrëveshje apo rregullime do të respektohen nga Kosova.

ANEKSI I DISPOZITAT KUSHTETUESE

Kushtetuta e ardhshme e Kosovës do të përfshijë por nuk do të kufizohet vetëm në parimet dhe elementet vijuese.

Neni 1 Dispozitat themelore

Kushtetuta e Kosovës:

1.1 Në të gjitha dispozitat e saj do të jetë në pajtim me këtë zgjidhje dhe do të interpretohet në pajtim me këtë zgjidhje; në rast të mospërputhjeve mes dispozitave të Kushtetutës dhe dispozitave të kësaj zgjidhjeje, do të mbizotërojë e fundit.

1.2 Do t'i përfshijë dispozitat e parashikuara në nenin 1, parimet e përgjithshme të kësaj zgjidhjeje.

1.3 Do të konfirmojë që Kosova është shoqëri shumetnike, që bazohet në barazinë e të gjithë qytetarëve dhe në shkallën më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht, si dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve të saja dhe pjesëtarëve të tyre.

1.4 Do të konfirmojë që Kosova nuk ka fe zyrtare dhe se do të jetë e paanshme në çështjet e besimeve fetare.

1.5 Do të konfirmojë përgjegjësinë e autoriteteve kosovare për të promovuar dhe lehtësuar kthimin e sigurt dhe me dinjitet të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur nga Kosova dhe për t'i ndihmuar ata në kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre.

1.6 Do të parashikojë të drejtën e të gjithë qytetarëve të ish Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës më 1 janar të vitit 1998 dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë për ta fituar nënshtetësinë e Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm dhe çfarëdo nënshtetësie tjetër që ata mund të kenë.

Neni 2 Dispozitat për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

2.1 Kushtetuta do të parasheh që të drejtat dhe liritë e parapara me instrumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare në vijim do të jenë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë dhe do të kenë prioritet ndaj të gjitha ligjeve të tjera; asnjë ndryshim në Kushtetutën e Kosovës nuk do t'i pakësojë këto të drejta:

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj;
Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas;
Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve dhe Ndëshkimeve tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese;

2.2 Kushtetuta do të afirmojë parimin që të gjithë personat në Kosovë gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, siç parashihet me nenin 2.1 të këtij Aneksi pa diskriminim të çfarëdo lloji në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo mendimi tjetër, prejardhjes kombëtare apo sociale, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, statusit të lindjes apo ndonjë statusi tjetër. Kushtetuta gjithashtu do të afirmojë parimin që të gjithë personat në Kosovë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë, pa diskriminim, në mbrojtje të barabartë para ligjit.

2.3 Kushtetuta do të përfshijë nenet prej 1 deri në 3 mbi të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siç parashihet me Aneksin II të kësaj zgjidhjeje, të cilët drejtpërsëdrejti do të zbatohen në Kosovë.

2.4 Kushtetuta do të parasheh të drejtën për individët, të cilët pretendojnë se të drejtat dhe liritë që u garantohen atyre me kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik, që të parashtrijë ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese, pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve të tjera juridike.

Neni 3 Kuvendi i Kosovës

Sa i përket Kuvendit të Kosovës, Kushtetuta do të parasheh, mes tjerash, si vijon:

3.1 Kuvendi do të ketë 120 deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë në bazë të listave të hapura, nga të cilët 100 ulëse do t'u ndahen të gjitha partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme që ata i kanë marrë gjatë zgjedhjeve për Kuvend. Listat e kandidatëve do t'u kushtojnë një kujdes të duhur parimeve të njohura ndërkombëtarisht për barazinë gjinore, siç pasqyrohen në instrumentet e të drejtave të njeriut të paraqitura në nenin 2 të këtij Aneksi.

3.2 Për dy mandatet e para zgjedhore pas miratimit të Kushtetutës, Kuvendi i Kosovës do të ketë (20) ulëse të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në Kosovë, në mënyrën vijuese: dhjetë (10) ulëse do t'u ndahen partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës dhe dhjetë (10) ulëse do t'u ndahen komuniteteve të tjera si në vijim: komunitetit rom një (1) ulëse; komunitetit ashkali një (1) ulëse; komunitetit egjiptian një (1) ulëse; dhe një (1) ulëse shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali apo

egjiptas, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komunitetit boshnjak tri (3) ulëse; komunitetit turk dy (2) ulëse dhe komunitetit goran një (1) ulëse. Çdo ulëse e fituar përmes zgjedhjeve do të jetë ulëse shtesë, përveç dhjetë (10) ulëseve të rezervuara të cilat ju ndahen komunitetit serb të Kosovës përkatësisht komuniteteve të tjera.

3.3 Pas dy mandateve të para zgjedhore:

3.3.1 Partitë, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës do të kenë numrin e ulëseve në kuvend të fituar përmes zgjedhjeve të hapura, me minimum dhjetë (10) ulëse të garantuara në rast se numri i ulëseve të fituara është më i vogël se dhjetë (10).

3.3.2. Partitë, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet tjera, do të kenë numrin e ulëseve në kuvend të fituara përmes zgjedhjeve të hapura, me minimumin e ulëseve të garantuara siç parashihen me nenin 3.2, nëse numri i ulëseve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i ulëseve të parashikuara me nenin 3.2.

3.4 Grupi i anëtarëve të Kuvendit të cilët mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës si dhe grupi i anëtarëve të Kuvendit të cilët mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetet tjera, do të kenë secili më së paku një (1) përfaqësues në Kryesinë e Kuvendit.

3.5 Së paku një zëvendëskryesues i secilit komision parlamentar do të jetë nga radhët e komunitetit tjetër nga ai të cilit i përket kryesuesi.

3.6 Kompetencat dhe procedurat e tanishme të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve do të mbeten ashtu siç janë. Për sa i përket përbërjes së tij, pjesëtarët e komuniteteve do të përfaqësohen, mirëpo jo më shumë se një e treta (1/3) e anëtarëve të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve do të përfaqësojnë grupin e anëtarëve të kuvendit të cilët mbajnë ulëse të rezervuara për komunitetin serb të Kosovës dhe jo më shumë se një e treta (1/3) e anëtarëve të tij do të përfaqësojnë grupin e anëtarëve të Kuvendit që mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetet tjera të cilat nuk janë shumicë në Kosovë.

3.7 Për miratimin, ndryshimin apo shfuqizimin e ligjeve të paraqitura në vijim do të kërkohet shumica e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë të Kuvendit që u përkasin partive, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se u përkasin komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në Kosovë, siç është përcaktuar në nenin 3.2:

- a. Ligjet të cilët ndryshojnë kufijtë komunal, themelojnë apo shuajnë komunat, përcaktojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;

- b. Ligjet të cilat implementojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre përveç atyre të përcaktuara me Kushtetutë;
- c. Ligjet për përdorimin e gjuhëve;
- d. Ligjet për zgjedhjet lokale;
- e. Ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- f. Ligjet për lirinë fetare apo për marrëveshjet me komunitetet fetare;
- g. Ligjet për arsimin;
- h. Ligjet për përdorimin e simboleve (përfshirë simbolet e komunitetit) dhe festat publike

3.8 Pavarësisht nga dispozitat e nenit 3.7 të këtij Aneksi, të gjitha ligjet e nevojshme për implementimin e kushteve të kësaj zgjidhjeje, siç parashihen me Aneksin XII të saj, gjatë miratimit të tyre fillestar, nuk do t'i nënshtrohen kërkesave të nenit 3.7 të këtij Aneksi.

3.9 Asnjëri nga ligjet që i nënshtrohen kërkesave të nenit 3.7 apo propozimeve të cilat janë në kundërshtim me çfarëdo dispozite të kësaj zgjidhjeje, nuk mund t'i nënshtrohen referendumit.

3.10 Kuvendi do të themelojë rregulloren e vet të punës, e cila do të jetë në pajtim me parimet e transparencës dhe vendimmarrjes demokratike të hapur.

Neni 4 Kryetari i Kosovës

Sa i përket Kryetarit të Kosovës, Kushtetuta, mes tjerash, do të parasheh si në vijim:

4.1 Kryetari i Kosovës do të përfaqësojë unitetin e popullit.

4.2 Kryetari i Kosovës, mund t'i kthejë një herë Kuvendit për rishqyrtim çfarëdo propozimligji që ai e konsideron si të dëmshëm për interesat legjitime të një apo më shumë komuniteteve.

Neni 5 Qeveria e Kosovës

Sa i përket Qeverisë së Kosovës, Kushtetuta, mes tjerash, do të parasheh si në vijim:

5.1 Së paku një (1) ministër do të jetë nga komuniteti serb dhe një (1) ministër nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë i Kosovës; nëse janë më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, do të jetë edhe një ministër i tretë që përfaqëson një komunitet joshumicë të Kosovës.

5.2 Së paku dy zëvendësministra do të jenë nga komuniteti serb i Kosovës dhe dy zëvendësministra nga komunitetet tjera joshumicë; nëse janë më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, do të jetë edhe një zëvendësministër i tretë që përfaqëson komunitetin serb dhe një zëvendësministër tjetër që përfaqëson komunitetin tjetër joshumicë të Kosovës.

5.3 Zgjedhja e këtyre ministrave dhe zëvendësministrave do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet apo grupet që përfaqësojnë komunitetet joshumicë në Kosovë. Nëse caktohen jashtë anëtarësimit të Kuvendit të Kosovës, për këto ministra dhe zëvendësministra do të kërkohet miratim formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët u përkasin partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë.

5.4 Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore të njohura ndërkombëtarisht siç pasqyrohen në instrumentet e të drejtave të njeriut të paraqitura në nenin 2 të këtij Aneksi. Një këshill i pavarur mbikëqyrës për shërbimin civil do të sigurojë respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës.

Neni 6 Gjykata Kushtetuese dhe sistemi i drejtësisë

Sa i përket Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kushtetuta, mes tjerash, do të parasheh si në vijim:

6.1 Gjykata Kushtetuese do të përbëhet nga nëntë gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë.

6.1.1 Gjashtë (6) gjyqtarë do të emërohen nga Kryetari me propozim të Kuvendit. Nga gjashtë gjyqtarët e emëruar për mandatin e parë, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, dy (2) gjyqtarë do të shërbejnë për një mandat trivjeçar pa mundësi të rizgjedhjes, dy (2) gjyqtarë do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare pa mundësi të rizgjedhjes dhe dy (2) gjyqtarë do të shërbejnë për një periudhë nëntëvjeçare pa mundësi të rizgjedhjes. Më tutje, çdo gjyqtar i emëruar në Gjykatën Kushtetuese do të emërohet për një mandat nëntëvjeçar pa mundësi të rizgjedhjes. Gjyqtarët, mandati i të cilëve pritet të skadojë në fund të periudhës fillestare prej tre apo gjashtë vjetësh, do të zgjidhen me short nga Kryetari i Kosovës menjëherë pas emërimit të tyre.

6.1.2 Sa u përket katër (4) nga gjashtë pozitat gjyqësore, vendimi për të propozuar një person si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese do të kërkohet shumicën prej dy të tretave në Kuvend; sa i përket dy (2) pozitave të tjera, do të kërkohet pëlqimi i shumicës së anëtarëve të Kuvendit, duke përfshirë edhe pëlqimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të cilët mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë.

6.1.3 Tre gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut pas këshillimit me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar.

6.2 Dhjetë apo më shumë deputetë të Kuvendit, mes tjerash, do të kenë të drejtën që të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji apo vendimi të miratuar nga Kuvendi pranë Gjykatës Kushtetuese, si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe në atë procedural.

6.3 Pranë Gjykatës Kushtetuese, komunat mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjeve apo të akteve të Qeverisë të cilat cenojnë përgjegjësitë e tyre apo zvogëlojnë të hyrat e tyre.

Sa i përket sistemit të drejtësisë në Kosovë, mes tjerash, Kushtetuta do të parasheh si në vijim:

6.4 Gjyqtarët dhe prokurorët do të emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Kosovës vetëm pas propozimit të bërë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK). Të gjitha vendet e lira për pozita gjyqësore apo prokuroriale duhet të shpallen publikisht dhe të jenë të hapura për të gjithë kandidatët e kualifikuar të cilët do të përzgjedhen për propozim nga KGjK-ja në bazë të meritave, në pajtim me ligjin në fuqi dhe dispozitat e nenit 6.6 të këtij Aneksi.

6.5 Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të ketë pavarësi të plotë në kryerjen e funksioneve të tij me qëllim të sigurimit të një sistemi të integruar, të pavarur, profesional dhe të paanshëm të drejtësisë, sigurimit të qasjes në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë dhe garantimit që sistemi i drejtësisë së Kosovës është gjithëpërfshirës dhe pasqyron plotësisht natyrën shumetnike të Kosovës. Kjo nuk do të paragjykojë themelimin, në ndonjë fazë të mëvonshme, të ndonjë subjekti të posaçëm përgjegjës për çështjet që kanë të bëjnë me emërimin, shqiptimin e masave disiplinore dhe shkarkimin e prokurorëve, i cili nëse themelohet do të gëzojë të njëjtën pavarësi në kryerjen e funksioneve të tij.

6.6 Sa i përket rekrutimit, përzgjedhjes, emërimit, avancimit në detyrë dhe transferit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, autoritetet relevante në Kosovë do të sigurojnë që gjyqësia dhe shërbimi i prokurorisë të pasqyrojnë karakterin shumetnik të Kosovës dhe nevojën për një përfaqësim të barabartë proporcional të të gjitha komuniteteve në Kosovë duke u kushtuar vëmendje të duhur parimeve të njohura ndërkombëtarisht për barazi gjinore, siç pasqyrohet në instrumentet e të drejtave të njeriut të paraqitura në nenin 2 të këtij Aneksi.

6.7 Përgjegjësitë e tanishme dhe roli i Ombudspersonit mbeten ashtu siç janë.

Neni 7 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

7.1 Komisioni do të ketë njëmbëdhjetë (11) anëtarë përfshirë këtu edhe kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i cili do të emërohet nga Kryetari i Kosovës nga radhët e Gjykatës Supreme dhe gjykatave të qarkut.

7.2 Gjashtë (6) anëtarë do të emërohen nga gjashtë grupet më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e ulëseve të rezervuara. Nëse më pak grupe janë të përfaqësuara në Kuvend, grupi apo grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtar do të emërohet nga deputetët e

Kuvendit të cilët mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetet tjera të cilat nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 8 Decentralizimi / vetëqeverisja lokale

Sa i përket vetëqeverisjes lokale në Kosovë, Kushtetuta, mes tjerash, do të parasheh se:

8.1 Kosova do të përbëhet prej komunave të cilat do të gëzojnë një shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe të cilat inkurajojnë dhe sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në jetën demokratike.

8.2 Kompetencat dhe kufijtë e komunave do të përcaktohen me ligj.

8.3 Komunitat kanë të drejtë për burime lokale të të ardhurave dhe pranim të financimit të duhur nga autoritetet qendrore.

8.4 Komunitat kanë të drejtë për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar në fushat e kompetencave të tyre vetjake dhe të zgjeruara.

Neni 9 Dispozitat ekonomike

Sa i përket sektorit ekonomik/financiar të Kosovës, Kushtetuta, mes tjerash, do të parasheh se:

9.1 Kosova do të përdorë një valutë si monedhë të ligjshme.

9.2 Kosova do të ketë një autoritet të pavarur qendror bankar.

9.3 Kosova do të themelojë organet e pavarura rregullative të tregut.

Neni 10 Ndryshimet kushtetuese

Sa i përket ndryshimeve të Kushtetutës, Kushtetuta, mes tjerash, do të parasheh se:

10.1 Për çdo ndryshim të Kushtetutës do të kërkohet miratimi i dy të tretave të deputetëve të Kuvendit përfshirë këtu dy të tretat e deputetëve të Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë.

10.2 Asnjë ndryshim i Kushtetutës nuk mund të pakësojë të drejtat dhe liritë e paraqitura në nenin 2 të këtij Aneksi.

Neni 11 Dispozitat kalimtare

Kushtetuta gjithashtu do të parasheh që të gjitha autoritetet në Kosovë t'u japin fuqi ligjore vendimeve apo akteve të autoritetit ndërkombëtar të cilit i është dhënë mandati për mbikëqyrjen e zbatimit të zgjidhjes dhe do t'i përmbahen të gjitha detyrimeve të Kosovës të parashikuara me këtë zgjidhje.

ANEKSI II

TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE

Neni 1 Dispozitat themelore

1.1 Banorët të cilët i përkasin të njëjtit grupi kombëtar apo etnik, gjuhësor apo fetar, të cilët tradicionalisht janë të pranishëm në territorin e Kosovës (komunitetet) do të kenë të drejta të posaçme siç parashihen me këtë Aneks, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të parashikuara me nenin 2 të Aneksit I të kësaj zgjidhjeje.

1.2 Çdo pjesëtar i komunitetit do të ketë të drejtë që lirisht të zgjedh të trajtohet apo të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe asnjë diskriminim nuk do të rezultojë nga zgjidhja e tij apo nga ushtrimi i të drejtave të cilat janë të ndërlidhura me këtë zgjidhje.

1.3 Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që lirshëm të shprehin, avancojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre dhe atributet si komunitet.

1.4 Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me veti detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Kosovës dhe nuk do të shkel të drejtat e të tjerëve.

Neni 2 Detyrimet për Kosovën

2.1 Kosova do të krijojë kushtet e duhura të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, mbrojnë dhe zhvillojnë identitetet e tyre. Qeveria në veçanti do të përkrahë iniciativat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare.

2.2 Kosova do të promovojë frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe do të respektojë standardet e parashikuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Kartën Evropiane për Gjuhët Regjionale apo të Pakicave.

2.3 Kosova do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t'i nënshtrohen kërcënimeve apo veprave të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar.

2.4 Kosova, sipas nevojës, do të miratojë masat adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit.

2.5 Kosova do të promovojë ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Kosova do të ketë një detyrë

*** UNOFFICIAL TRANSLATION - PËRKTHIM JOZYRTAR ***

të posaçme për të siguruar mbrojtje efektive të tërësive të objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet.

2.6 Kosova do të ndërmer veprime efektive kundër të gjithë atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve. Kosova do të përmbahet nga politikat apo praktikat që kanë për qëllim asimilimin, kundër vullnetit të tyre, të personave të cilët u përkasin komuniteteve dhe do të mbrojnë këta persona nga çfarëdo veprimi që ka për qëllim një asimilim të tillë.

2.7 Kosova do të sigurojë, në baza jodiskriminuese, që të gjithë komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrjnë të drejtat e tyre të specifikuar në vazhdim.

Neni 3 Të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre

3.1 Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtën, në mënyrë individuale apo si komunitet që të:

- a. Shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe ruajtjen e elementeve thelbësore të identitetit të tyre, gjegjësisht fesë, gjuhës, traditave dhe kulturës së tyre.
- b. Pranojnë arsimim publik të të gjitha niveleve, në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës sipas zgjidhjes së tyre;
- c. Pranojnë arsimim publik parashkollor, primar dhe sekondar në gjuhën e tyre, deri në masën e parashikuar me ligj, ku pragu për themelimin e paraleleve apo shkollave të veçanta për këtë qëllim do të jetë më i ulët se ai që zakonisht parashihet për institucionet arsimore;
- d. Themelojnë dhe menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.
- e. Përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirshëm në jetën private dhe publike;
- f. Përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale apo zyrat lokale të autoriteteve qendrore në fushat në të cilat ata përfaqësojnë një pjesë të mjaftueshme të popullatës, në pajtim me ligjin. Shpenzimet e bëra për përdorimin e interpretuesit apo përkthyesit do të mbulohen nga autoritetet kompetente.
- g. Përdorin dhe shfaqin simbolet e komunitetit në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- h. Kenë emrat personale, të regjistruar në formën e tyre origjinale dhe në shkrimin e gjuhës së tyre si dhe të kthejnë emrat e tyre në formën origjinale nëse të njëjtat janë ndryshuar me dhunë;

i. Kenë emërtime lokale, emërtime të rrugëve dhe tregues tjerë topografik që pasqyrojnë dhe janë të ndjeshëm ndaj karakterit shumetnik dhe shumëgjuhësor të zonës në fjalë;

j. Qasje të garantuar dhe përfaqësim të posaçëm në mediat transmetuese publike si dhe programet në gjuhën e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;

k. E drejta për të krijuar dhe përdorur mediat e tyre vetjake, përfshirë këtu ofrimin e informatave në gjuhën e tyre, ndër të tjera, përmes gazetave ditore dhe shërbimeve kabllovike, dhe përdorimin e një numri të rezervuar të frekuencave për mediat elektronike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Kosova do të ndërmerë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e një plani ndërkombëtar të frekuencave, për t'i mundësuar komunitetit serb në Kosovë qasje në një kanal televiziv të pavarur të licencuar në gjuhën serbe në mbarë Kosovën;

l. Gëzojnë kontakte të papenguara në mes vete përbrenda Kosovës dhe të themelojnë dhe mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet, në veçanti me ata me të cilët ndajnë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar apo trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;

m. Gëzojnë kontakte të papenguara me dhe marrin pjesë, pa diskriminim, në aktivitetet e organizatave joqeveritare lokale, regjionale dhe ndërkombëtare;

n. Themelojnë shoqata për kulturë, art, shkencë dhe arsim si dhe shoqata të studiuësve dhe shoqata tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre.

Neni 4 Pjesëmarrja e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje

4.1 Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të përfaqësohen në Kuvend. Legjislacioni i caktuar në mënyrë specifike me kushtetutë nuk mund të nxirret apo ndryshohet pa pëlqimin e deputetëve të Kuvendit të cilët mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetet, siç parashihet me nenin 3.7 të Aneksit I.

4.2 Përbërja e Qeverisë dhe procesi i emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve do të parasheh modalitetet e posaçme të cilat sigurojnë pjesëmarrjen e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siç parashihet me Aneksin I dhe IV.

4.3 Do të jetë një Këshill konsultativ për komunitete në kuadër e Kryetarit të Kosovës në të cilin do të përfaqësohen të gjitha komunitetet. Ky Këshill konsultativ për komunitete do të përbëhet, mes tjerash, nga përfaqësuesit e asociacioneve të komuniteteve. Mandati i Këshillit konsultativ për komunitete do të përfshijë:

4.3.1 Ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës;

4.3.2 Jep mundësinë komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme iniciativat legislative dhe politike të cilat mund të përgatiten nga qeveria, për të sugjeruar iniciativa të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse.

4.3.3 Çdo përgjegjësi apo funksion tjetër i parashikuar me këtë zgjidhje apo në pajtim me ligjin.

4.4 Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë proporcional në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu në veçanti shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin që qeveris administratën publike.

4.5 Në komunat në të cilat së paku dhjetë (10) përqind e banorëve i përkasin komuniteteve të cilat nuk janë në shumicë në ato komuna, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit komunal do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve. Pozita e zëvendëskryetarit do të mbahet nga kandidati që i përket popullatës joshumicë që ka marrë shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje për kuvend komunal. Zëvendëskryetari për komunitete do të promovojë dialog mes komuniteteve dhe do të shërbejë si pikë formale e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve joshumicë në takimet e Kuvendit dhe punën e tij. Zëvendëskryetari gjithashtu do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e ankesave që parashtrohen nga komunitetet apo pjesëtarët e tyre se aktet apo vendimet e kuvendit komunal shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Zëvendëskryetari do t'ia referojë këto çështje kuvendit komunal për shqyrtim të sërishëm të vendimit apo aktit. Në rast se kuvendi komunal zgjedh që të mos shqyrtojë aktin apo vendimin e vet, apo nëse zëvendëskryetari vlerëson se rezultati edhe pas shqyrtimit paraqet shkelje të të drejtave të garantuara me kushtetutë, zëvendëskryetari mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë këtë rast për shqyrtim.

ANEKSI III DECENTRALIZIMI

Do të themelohet një sistem i avancuar dhe i qëndrueshëm i vetëqeverisjes lokale në Kosovë për trajtimin e shqetësimeve legjitime të serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera që nuk përbëjnë shumicë në Kosovë dhe pjesëtarëve të tyre, për të inkurajuar dhe siguruar pjesëmarrje aktive në jetën publike dhe për të fuqizuar qeverisjen e mirë dhe efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve publike anembanë Kosovës, në pajtim me parimet dhe dispozitat në vijim:

Neni 1 Dispozitat themelore

1.1 Vetëqeverisja lokale në Kosovë do të bazohet në parimet e Kartës Evropiane për

Vetëqeverisjen Lokale dhe veçanërisht në parimin e subsidiaritetit.

1.2 Me vetëqeverisjen lokale në Kosovë do të mbrohen dhe promovohen standardet e pranuar ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut, duke marrë veçanërisht parasysh nevojat e komuniteteve joshumicë dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë.

1.3 Parimet kryesore të decentralizimit do të përcaktohen në Kushtetutë, siç parashihet në nenin 8 të Aneksit I të kësaj zgjidhjeje.

Neni 2 Legjislacioni i Kosovës për vetëqeverisje lokale

2.1 Kosova do të nxjerrë ligjin e ri mbi vetëqeverisjen lokale brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje, i cili do të përforcojë kompetencat dhe organizimin e komunave, siç parashihet në këtë Aneks dhe në pajtim me Aneksin XII.

2.2 Kosova do të nxjerrë ligjin e ri mbi kufijtë komunal brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje, me të cilin do të përcaktohen komunat e reja, siç parashihet në këtë Aneks dhe në pajtim me Aneksin XII.

2.3 Kosova do të nxjerrë legjislacionin themelor në pajtim me parimet e përcaktuara në këtë Aneks, në mënyrë që të sigurohet trajtim i paanshëm dhe standarde minimale për të gjitha komunat, lidhur me rregullimin dhe menaxhimin e çështjeve publike që bien në përgjegjësinë e tyre, veçanërisht duke respektuar parimin e subsidiaritetit, duke treguar vëmendje të duhur për qëndrueshmërinë fiskale të komunave dhe qeverisë qendrore.

Neni 3 Kompetencat komunale

3.1 Komunat në Kosovë do të kenë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për aq sa ata kanë të bëjnë me interesin lokal, duke respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi në fushat në vijim (më tej, kompetencat vetjake).

- a. Zhvillimi lokal ekonomik;
- b. Planifikimi urban dhe rural;
- c. Përdorimi dhe zhvillimi i tokës;
- d. Implementimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve të kontrollit të ndërtimit;
- e. Mbrojtja lokale e mjedisit;
- f. Ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes lokale;
- g. Përgjigjja ndaj situatave emergjente lokale;
- h. Ofrimi i arsimit publik parashkollor, primar dhe sekondar, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të arsimit, punësimin, pagimin e rrogave dhe trajnimin e drejtuesve dhe administratorëve të arsimit;
- i. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit familjar dhe i atyre të mirëqenies sociale siç është kujdesi për njerëzit e lëndueshëm, kujdesi për të birësuarit, kujdesi për fëmijët, kujdesi për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të kujdesit, rekrutimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- j. Sigurimin Shërbimet familjare dhe shërbimet tjera;
- k. Banimi publik;
- l. Shëndetësia publike;
- m. Licencimi i shërbimeve dhe objekteve lokale, përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe ato të kohës së lirë, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit e rrugës, transportin lokal publik dhe taksitë;
- n. Emërimi i rrugëve, lagjeve dhe vendeve të tjera publike;
- o. Ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike;
- p. Turizmi;
- q. Aktivitetet kulturore dhe të kohës së lirë;
- r. Çdo çështje tjetër që në mënyrë të shprehur nuk përjashtohet nga kompetenca e tyre apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër;

Neni 4 Kompetencat e zgjeruara vetjake komunale

4.1 Disa komuna të caktuara në Kosovë do të kenë kompetenca vetjake të zgjeruara si vijon:

4.1.1 Komuna e Mitrovicës Veriore do të ketë kompetenca për arsimin e lartë, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, punësimin, pagimin e rrogave dhe trajnimin e drejtuesve dhe administratorëve të arsimit;

4.1.2 Komuna e Mitrovicës Veriore, e Graçanicës dhe e Shtërpcës do të kenë kompetenca për ofrimin e kujdesit shëndetësor sekondarë, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor, punësimin, pagimin e rrogave dhe trajnimin e personelit dhe administratorëve të kujdesit shëndetësor;

4.1.3 Të gjitha komunat në të cilat komuniteti serb është shumicë do të kenë:

a. Autoritetin për të ushtruar përgjegjësinë për çështje kulturore, duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore të serbëve dhe të tjerëve brenda territorit komunal si dhe përkrahjen për komunitetet fetare lokale, në pajtim me dispozitat e Aneksit V të kësaj zgjidhjeje;

b. Të drejta të avancuara pjesëmarrëse në zgjedhjen dhe shkarkimin e komandantëve të stacioneve policore, siç përcaktohet në nenin 2.6 të Aneksit VIII të kësaj zgjidhjeje.

4.2 Për sa u përket këtyre kompetencave të zgjeruara vetjake, Kosova do të nxjerrë legjislacionin kornizë për të ofruar qasje të barabartë ndaj shërbimeve publike; standarde minimale cilësore dhe sasiore në ofrimin e shërbimeve publike; kualifikime minimale të personelit dhe objekteve të trajnimit; parimet e përgjithshme mbi licencimin dhe akreditimin e ofruesve të shërbimeve publike.

4.3 Komunat që zbatojnë kompetencat e zgjeruara vetjake mund të bashkëpunojnë me çdo komunë tjetër në ofrimin e shërbimeve të tilla.

Neni 5 Kompetencat e deleguara komunale

5.1 Autoritetet qendrore në Kosovë do të delegojnë përgjegjësi tek komunat mbi kompetencat vijuese, në pajtim me ligjin:

- a. Regjistrat kadastror;
- b. Regjistrat civilë;
- c. Regjistrimi i votuesve;
- d. Regjistrimi dhe licencimi i bizneseve;
- e. Shpërndarja e pagesave të ndihmës sociale (duke përjashtuar pensionet) dhe
- f. Mbrojtjen e pyjeve.

5.2 Autoritetet qendrore, sipas nevojës, mund të delegojnë kompetenca shtesë tek komunat në përputhje me ligjin.

Neni 6 Shqyrtimi administrativ i aktiviteteve komunale

6.1 Shqyrtimi administrativ i aktiviteteve komunale nga ana e autoriteteve qendrore në fushat e kompetencave të tyre vetjake do të kufizohet në sigurimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjin në fuqi.

6.1.1 Autoriteti mbikëqyrës administrativ mund të kërkojë nga komuna që të rishqyrtojë vendimet apo aktet tjera ligjore që konsiderohen se janë në mospërputhje me Kushtetutën apo ligjet e miratuara në pajtim me këtë zgjidhje. Kërkesa e tillë do të deklarojë shkeljet e

pretenduar ndaj Kushtetutës apo ligjit. Kërkesa nuk do të pezullojë ekzekutimin e vendimit komunal apo ndonjë akti tjetër ligjor.

6.1.2 Nëse komuna pranon kërkesën në përputhje me nenin 6.1.1 të këtij Aneksi, ajo mund të vendosë të pezullojë ekzekutimin e vendimit apo aktit tjetër ligjor në pritje të shqyrtimit nga ana e autoriteteve komunale.

6.1.3 Nëse komuna refuzon kërkesën apo vërteton vendimin apo aktin e tij në shqyrtim, autoriteti mbikëqyrës administrativ mund të kundërshtojë vendimin apo aktin tjetër ligjor në gjykatën e qarkut kompetente për territorin e komunës. Gjykata e qarkut, si masë të përkohshme, mund të urdhërojë pezullimin e zbatimit të vendimit të kontestuar apo aktit tjetër ligjor.

6.2 Sa i përket kompetencave të deleguara komunale, autoritetet qendrore mund të shqyrtojnë përshtatshmërinë e vendimit komunal të dhënë apo të aktit tjetër, krahas pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin e miratuar në pajtim me këtë zgjidhje dhe, së këndejmi, mund të pezullojnë, modifikojnë apo zëvendësojnë, sipas nevojës, ekzekutimin e vendimit komunal apo të ndonjë akti tjetër.

Neni 7 Arsimi

7.1 Sa u përket planprogrameve arsimore të shkollave të Kosovës që ofrojnë mësim në gjuhën serbe:

7.1.1 Shkollat të cilat ofrojnë mësim në gjuhën serbe mund të zbatojnë planprograme apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, me njoftim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës.

7.1.2 Në rast se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës kundërshton përdorimin e planprogramit apo tekstit shkollor të veçantë, çështja do t'i referohet një komisioni të pavarur për të shqyrtuar pajtueshmërinë e planprogramit apo tekstit shkollor në fjalë me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin e miratuar në pajtim me këtë zgjidhje.

7.1.3 Komisioni i pavarur do të përbëhet nga tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb, tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës dhe një (1) anëtar ndërkombëtar i zgjedhur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, i cili e përfaqëson atë.

7.1.4 Komisioni do t'i merr të gjitha vendimet me shumicën e votave, dhe kryesimi do të bëhet përmes rotacionit në mes të përfaqësuesit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe përfaqësuesit të zgjedhur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës çdo vit.

7.2 Sa i përket universitetit publik në gjuhën serbe:

7.2.1 Universiteti i Mitrovicës Veriore do të jetë institucion autonom i arsimit të lartë. Universiteti do të miratojë statutin që do të saktësojë organizimin dhe qeverisjen e brendshëm të tij si dhe procedurat dhe ndërveprimin me autoritetet publike, në pajtim me legjislacionin kornizë qendror, i cili do të shqyrtohet nga një komision i pavarur, siç parashihet në nenin 7.2.2 të këtij Aneksi.

7.2.2 Vendimet mbi pajtueshmërinë e Statutit me legjislacionin kornizë qendror, standardet evropiane dhe praktikat më të mira dhe mbi çështjet që kanë të bëjnë me akreditimin e Universitetit brenda sistemit universitar të Kosovës, do të merren nga një komision i pavarur i përbërë nga tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga Universiteti, tre (3) përfaqësues të zgjedhur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës dhe një (1) anëtar ndërkombëtar i zgjedhur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, i cili e përfaqëson atë. Komisioni do t'i merr të gjitha vendimet me shumicën e votave dhe kryesimi do të bëhet përmes rotacionit në mes të përfaqësuesit të zgjedhur nga Universiteti apo përfaqësuesit e zgjedhur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës çdo vit.

7.2.3 Komuna e Mitrovicës Veriore do të ketë autoritet për të zbatuar përgjegjësinë e këtij Universiteti publik në gjuhën serbe, në pajtim me nenin 4.1.1 të këtij Aneksi. Universiteti do të ketë Bordin e përbërë nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy do të caktohen nga komuna dhe pesë (5) do të zgjedhen nga fakulteti apo nga organi i studentëve të Universitetit. Dy (2) anëtarët tjerë do të zgjedhen në mënyrën e përcaktuar në statutin e Universitetit. Komuna gjithashtu do të sigurojë që Universiteti të ketë objekte dhe financim adekuat për veprimtarinë e tij.

7.2.4 Komuna e Mitrovicës Veriore mund të bashkëpunojë me çdo komunë tjetër për drejtimin e universitetit.

Neni 8 Financat lokale

8.1 Komunat do të kenë të drejtë të caktojnë strukturën dhe lartësinë e buxhetit të tyre vetjak që mbulon detyrat që bien brenda kompetencave të tyre. Legjislacioni qendror do të përcaktojë kërkesat publike të menaxhimit dhe përgjegjësisë financiare të zbatueshme për të gjitha komunat, në pajtim me standardet ndërkombëtare.

8.2 Komunat do të kenë të drejtë në burimet e tyre vetjake financiare, që do të përfshijnë autoritetin për të vënë apo mbledhur tatimet lokale, pagesat dhe tarifën. Komuna nuk do të vë apo mbledhë tarifa doganore, tatimet në të ardhura të personave fizikë dhe juridikë, TVSh-në dhe detyrimet e akcizës, tatimet në kapital, përveç tatimit në pronën e paluajtshme që gjendet brenda komunës apo tarifa të tjera ekuivalente me detyrimet dhe tatimet e tilla.

8.3 Sistemi ekzistues i granteve kryesisht të rezervuara qendrore do të korrigohet në mënyrë që të përfshijë sistemin e drejtë dhe transparent të granteve të përgjithshme, duke siguruar autonominë më të madhe komunale në ndarjen dhe shpenzimin e fondeve qendrore.

8.3.1 Formula e shpërndarjes së granteve të përgjithshme do të sigurojë një shkallë të arsyeshme të stabilitetit të të ardhurave komunale, një masë adekuate për barazimin e komunave me baza të ndryshme tatimore, dhe një ndarje adekuate e burimeve për komunitetet joshumicë në komunat përkatëse.

8.3.2 Formula e shpërndarjes së granteve të përgjithshme do të merr parasysh, në mes tjerash, madhësinë fizike të komunës, numrin e banorëve duke përfshirë numrin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në komunë, dhe qasjen përkatëse të banorëve të komunës në shërbimet publike.

8.3.3 Baza e granteve të përgjithshme si përqindje e buxhetit të përgjithshëm të Qeverisë dhe formula e shpërndarjes do të caktohen me ligj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.

8.4 Pavarësisht nga dispozitat e nenit 8.3 të këtij Aneksi, komunat me përgjegjësi për kompetenca të zgjeruara vetjake siç parashihet në nenin 4 të këtij Aneksi, do të kenë të drejtë në fonde qendrore shtesë përbrenda kufizimeve të përcaktuara nga standardet minimale cilësore dhe sasiore për ofrimin e shërbimeve publike lidhur me ushtrimin e këtyre përgjegjësi, në pajtim me legjislacionin kornizë qendror.

8.5 Komunat do të sigurojnë auditime të brendshme të pavarura dhe objektive së paku një herë në vit dhe do t'u nënshtrohen auditimeve të jashtme të pavarura të rastit të ndërmarrja nga një autoritet autonom, në mënyrë që të sigurojnë menaxhim efektiv të burimeve publike, rezultatet e të cilit duhet të publikohen.

Neni 9 Bashkëpunimi ndërkomunal

9.1 Duke u bazuar në parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, komunat do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë dhe të krijojnë partneritete me komunat tjera të Kosovës, për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët, në pajtim me ligjin.

9.1.1 Përgjegjësitë komunale në fushat e tyre vetjake dhe kompetencat e tyre të zgjeruara vetjake mund të ushtrohen përmes partneriteteve komunale me përjashtim të ushtrimit të kompetencave themelore komunale siç janë zgjedhja e organeve komunale dhe emërimi i zyrtarëve komunalë, përcaktimi i buxhetit komunal dhe miratimi i akteve rregullative të zbatueshme ndaj qytetarëve në përgjithësi.

9.1.2 Partneritetet komunale mund t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për implementimin dhe ushtrimin e bashkëpunimit funksional, mes tjerash, përmes themelimit të një organi vendimmarrës të përbërë nga përfaqësuesit e emëruar nga

kuvendet e komunave pjesëmarrëse, punësimi dhe shkarkimi të personelit administrativ dhe këshillëdhënës dhe vendimeve mbi nevojat për financim dhe nevojave tjera operationale të partneritetit.

9.1.3 Vendimet dhe aktivitetet e partneritetit do t'i nënshtrohen kërkesave të raportimit tek autoriteti kompetent qendror dhe shqyrtimit administrativ për pajtueshmëri me legjislacionin, në pajtim me dispozitat e nenit 6.1 të këtij Aneksi.

9.2 Bazuar në parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, komunat do të kenë të drejtë të formojnë dhe marrin pjesë në asociacionet e komunave të Kosovës për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tyre të përbashkëta, në pajtueshmëri me ligjin.

9.2.1 Anëtarësimi në asociacionet e tilla do të kufizohet në komuna të Kosovës. Asociacionet e tilla mund të bashkëpunojnë me homologët e tyre ndërkombëtarë.

9.2.2 Asociacionet e tilla mund t'u ofrojnë anëtarëve të tyre disa shërbime, duke përfshirë trajnime, ngritje të kapaciteteve, ndihmë teknike, hulumtim lidhur me kompetencat komunale dhe rekomandime të politikave.

9.3 Komunat e angazhuara në një partneritet apo asociacion, në përputhje me dispozitat e neneve 9.1 dhe 9.2 të këtij Aneksi, do të publikojnë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe buxhetin e partneritetit / asociacionit, në pajtim me ligjin.

Neni 10 Bashkëpunimi me institucionet në Republikën e Serbisë

10.1 Komunat do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë, brenda kompetencave të tyre, me komunat dhe institucionet, përfshirë agjencitë qeveritare të Republikës së Serbisë. Bashkëpunimi i tillë do të merr formën e ofrimit të ndihmës financiare dhe teknike nga ana e institucioneve të Serbisë, duke përfshirë edhe ndihmën me ekspertë profesionistë dhe pajisje, në implementimin e kompetencave komunale.

10.2 Komunat paraprakisht do të njoftojnë Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal të Kosovës për çfarëdo qëllimi për t'u angazhuar në një bashkëpunim të tillë. Njoftimi do të përfshijë projekt marrëveshjen ndërmjet komunës dhe institucionit të propozuar partner të Serbisë.

10.3 Projekt marrëveshja e bashkëpunimit do të përcaktojë fushat e bashkëpunimit të paraparë, ofrimin e ekspertëve dhe pajisjeve, nivelin e financimit dhe mekanizmat e vetëpunues dhe rregullimet tjera relevante procedurale, në pajtim me kërkesat e menaxhimit të financave publike që janë të zbatueshme për të gjitha komunat.

10.4 Qëllimi i tillë për të bashkëpunuar dhe projekt marrëveshja e cila e shoqëron atë mund t'i nënshtrohen shqyrtimit nga Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal të Kosovës për pajtueshmërinë e saj me legjislacionin qendror kornizë. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 6.1 të këtij Aneksi, Ministria në përputhje me shqyrtimin e tillë mund të urdhërojë ndryshimet në projekt marrëveshjen e bashkëpunimit apo nëse shkelja e rëndë e

ligjit nuk mund të trajtohet me mjete juridike ndryshe, Ministria mund të pezullojë bashkëpunimin e synuar. Komuna mund të kundërshtojë veprimin e tillë të Ministrisë në gjykatën e qarkut kompetente për territorin e komunës.

10.5 Partneritetet ndërmjet komunave të Kosovës do të kenë të drejtë për marrëdhënie të drejtpërdrejta me institucionet e Republikës së Serbisë vetëm deri në masën e nevojshme për zbatimin praktik të aktiviteteve të partneritetit.

10.6 Do të themelohet një komision i përbashkët i Republikës së Serbisë / Kosovës për të nxitur bashkëpunimin e tillë me institucionet në Republikën e Serbisë dhe për të trajtuar çështjet posaçërisht të ndjeshme ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit që kanë të bëjnë me këtë bashkëpunim.

Neni 11 Financimi i aktiviteteve komunale nga Republika e Serbisë

11.1 Komunat do të kenë të drejtë të pranojnë ndihma financiare nga Republika e Serbisë që i nënshtrohen dispozitave në vijim:

11.1.1 Çdo ndihmë financiare për komunat e Kosovës nga Republika e Serbisë do të jetë e kufizuar në qëllimin e vet për ushtrimin e përgjegjësive të komunës në fushat e kompetencave të saja vetjake, do të jetë transparent dhe do të publikohet.

11.1.2 Komunat mund të pranojnë ndihma financiare nga Republika e Serbisë nëpërmjet xhironlogarive në bankat komerciale të certifikuara nga Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës. Thesari Qendror do të njoftohet për çdo pranim të tillë.

11.1.3 Komunat që pranojnë ndihma financiare nga Republika e Serbisë do t'i raportojnë këto ndihma së bashku me shpenzimet gjegjëse në buxhetet e tyre komunale.

11.1.4 Ndihamat financiare nga Republika e Serbisë për komunat e Kosovës nuk do të kompensojnë dhe zvogëlojnë ndarjen e granteve dhe burimeve të tjera që u ofrohen komunave në pajtim me nenet 8.3 dhe 8.4 të kësaj zgjidhjeje dhe nuk do t'u nënshtrohen tatimeve, tarifave dhe ngarkesave të asnjë lloji të shqiptuara nga ndonjë autoritet qendror.

11.2 Transferet individuale, përfshirë pensionet e qytetarëve individualë të Kosovës mund realizohen nëpërmjet financimit nga Republika e Serbisë.

Neni 12 Krijimi i komunave të reja

12.1 Komunat e reja do të krijohen ashtu siç janë përcaktuar në shtojcën e këtij Aneksi dhe do të përcaktohen me Ligjin e ri mbi kufijtë komunal.

12.2 Pas hyrjes në fuqi të Ligjit mbi kufijtë komunal, autoritetet e Kosovës dhe Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) do të ndërmarrin të gjitha përgatitjet e nevojshme për të siguruar që deri në momentin e mbajtjes së zgjedhjeve lokale, të jenë ndarë dhe themeluar të gjitha burimet, pronat dhe strukturat administrative të kërkuara

për krijimin dhe funksionimin e këtyre komunave të reja. Përgatitjet e tilla do të përfshijnë si në vijim:

12.2.1 PCN-ja, në këshillim me komunitetet lokale në komunat e reja, apo në rastin e Novobërdës, në zonat e reja kadastrale dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, do të emërojë ekiye përgatitore komunale (EPK) për t'u përgatitur për krijimin e komunave të tyre të reja përkatëse dhe detyrat tjera të ndërlidhura siç kërkohet nga PCN-ja.

12.2.2 Gjatë përgatitjeve të tilla, funksionet ekzekutive përkitazi me komunat e reja dhe ofrimin e shërbimeve publike për to, do të mbeten në përgjegjësi të komunave të mëhershme në këshillim me EPK-të.

12.2.3 Sa i përket komunës së tanishme të Mitrovicës, rregullimet për krijimin e komunës së Mitrovicës Veriore janë ato të parashikuara në nenin 13 të këtij Aneksi.

12.2.4 Këto dhe rregullimet tjera kalimtare ndërmjet komunave të mëhershme dhe komunave të reja do të parashihen me Ligjin mbi kufijtë komunal.

12.3 Menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve lokale, të gjitha funksionet dhe kompetencat ekzekutive do të barten nga komunat paraprake tek qeveritë e porsazgjedhura të komunave të reja, në pajtim me këtë zgjidhje. Autoritetet qendrore të Kosovës do të sigurohen se i tërë financimi për komunat e reja iu është ndarë dhe është pranuar nga to, dhe do të ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për t'u siguruar që komunat e reja të jenë në gjendje të fillojnë veprimtarinë e tyre si njësi efektive territoriale të vetëqeverisjes lokale.

12.4 Pavarësisht nga dispozitat e nenit 12.1 të këtij Aneksi, Kosova do të hyjë në konsultime me komunitetet joshumicë, në rastet kur ky komunitet përbën së paku 75% të popullsisë në një vendbanim të përqendruar me popullsi të gjithmbarshme prej së paku 5000 banorësh, me qëllim të krijimit të komunave të reja.

Neni 13 Mitrovica

13.1 Në territorin e komunës aktuale të Mitrovicës do të krijohen dy komuna të reja, Mitrovica e Veriut dhe Mitrovica e Jugut, me kufij komunal të përcaktuar në shtojcën e këtij Aneksi III.

13.2 Do të krijohet një bord i përbashkët i komunave të Mitrovicës Veriore dhe Mitrovicës Jugore, i cili do të zhvillojë bashkëpunim funksional në fushat e kompetencave të tyre, sipas marrëveshjes mes vetë komunave.

13.3 Bordi i përbashkët do të përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, me nga pesë (5) përfaqësues të zgjedhur nga secila komunë dhe një (1) përfaqësues ndërkombëtar që do të zgjidhet nga PCN-ja. Bordi i përbashkët do të udhëhiqet nga përfaqësuesi ndërkombëtar.

13.4 PCN-ja do të hapë një zyrë të ndarë në Mitrovicë, e cila posaçërisht do të përqendrohet në fushat e sigurisë / sundimit të ligjit, lirisë së lëvizjes / kthimit, të drejtat pronësore / të banimit, dhe zhvillimin ekonomik, siç parashihet në Aneksin IX të kësaj zgjidhjeje.

13.5 Gjatë periudhës tranzicionit prej 120 ditësh, PSSP-ja do të krijojë strukturat e përkohshme komunale në bashkërendim me PCN-në për komunën e re të Mitrovicës Veriore, sipas kufijve të përcaktuar në Shtojcën e këtij Aneksi. Pas përfundimit të periudhës së tranzicionit, këto struktura të përkohshme komunale do të mbesin nën autoritetin e PCN-së deri në mbajtjen e zgjedhjeve të para lokale në këtë komunë.

Neni 14 Regjistrimi i popullsisë dhe shqyrtimi i dispozitave të decentralizimit

14.1 Një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhjeje, Kosova, në këshillim me PCN-në, do të bëjë regjistrimin e popullsisë, i cili do të kryhet në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe do t'i nënshtrohet vëzhgimit ndërkombëtar. Në këtë kontekst, Republika e Serbisë dhe shtetet tjera fqinje do të autorizojnë regjistrimin përmes një agjencie ndërkombëtare të refugjatëve dhe personave të zhvendosur që dëshirojnë të kthehen në Kosovë.

14.2 Dispozitat e këtij Aneksi lidhur me krijimin e komunave të reja, përfshirë kufijtë administrativë të tyre, mund të rishqyrtohen dhe të ndryshohen sipas nevojës nga PCN-ja, në bashkërendim të ngushtë me Qeverinë e Kosovës dhe Këshillin konsultativ për komunitete, brenda gjashtë muajsh nga dorëzimi i rezultateve përfundimtare të regjistrimit të popullsisë në Kosovë. Shqyrtimi do të marrë në konsideratë zhvillimet demografike në komuna dhe posaçërisht kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur nëpër komuna, si dhe funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e autoriteteve komunale dhe aktiviteteve të tyre.

SHTOJCË E ANEKSIT III
PËRCAKTIMI I KUFIJVE TË KOMUNAVE TË REJA

Zonat kadastrale (ZK) që do të formojnë secilën komunë janë të përcaktuara në vijim:

Graçanicë (16)

ZK Badoc
ZK Batushë
ZK Çagllavicë (sipas përcaktimit në hartën e bashkëngjitur III A)
ZK Dobratin
ZK Graçanicë
ZK Gushtericë e Ulët
ZK Gushtericë e Epërme
ZK Llapllasellë
ZK Lepi
ZK Livagjë
ZK Preoc
ZK Skullan
ZK Sushicë
ZK Suhadoll
ZK Radevë
ZK Uglar

Novobërdë (24)

ZK Bostan
ZK Bolec
ZK Bushincë
ZK Carevc
ZK Dragancë
ZK Izvor
ZK Jasenovik
ZK Kllobukar
ZK Koretishtë
ZK Kufcë e Epërme
ZK Llabjan
ZK Makresh i Ulët
ZK Makresh i Epërm
ZK Manishincë
ZK Miganoc
ZK Mozgovë
ZK Novobërdë
ZK Parallovë
ZK Prekoc
ZK Stanishor
ZK Strazhë

ZK Tërniqec
ZK Tirincë
ZK Zebincë

Ranillug (13)

ZK Bozhec
ZK Domoroc
ZK Drenoc
ZK Gllogoc
ZK Hodec
ZK Kormnjan i Epërm
ZK Kormnjan i Ulët
ZK Pançellë
ZK Rajanoc
ZK Ranillug
ZK Ropotovë e Madhe
ZK Ropotovë e Vogël
ZK Tomanc

Partesh (3)

ZK Budrikë e Poshtme
ZK Pasjan
ZK Partesh

Kllokot / Vërboc (8)

ZK Gërçar
ZK Kllokot
ZK Letnica
ZK Mogillë
ZK Shashar
ZK Vërboc
ZK Vërnakollë
ZK Vërnez

Mitrovicë Veriore

ZK Mitrovicë (sipas përcaktimit të bashkëngjitur në hartat III B, C)
ZK Suhodoll i Epërm (sipas përcaktimit të bashkëngjitur në hartat III B, C)
ZK Suhodoll i Poshtëm (sipas përcaktimit të bashkëngjitur në hartat III B, C)

ANEKSI IV SISTEMI GJYQËSOR

Neni 1 Struktura e gjykatave

1.1 Gjykata Supreme siguron zbatimin e njëtrajtshëm të ligjit duke vendosur mbi ankesat e paraqitura në pajtim me ligjin. Së paku pesëmbëdhjetë përqind (15%) të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por në asnjë rast më pak se tre (3) gjyqtarë do të jenë nga komunitetet joshumicë në Kosovës.

1.2 Së paku pesëmbëdhjetë përqind (15%) të gjyqtarëve të secilës gjykatë të qarkut, por në asnjë rast më pak se dy (2) gjyqtarë, do të jenë nga komunitetet joshumicë në Kosovë.

1.3 Nëse në njërën nga komunat e reja të krijuara në bazë të Aneksit III nuk ka gjykatë themelore, komuna me vendim të Kuvendit Komunal mund ta parqet kërkesën pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) për të vendosur mbi themelimin e gjykatës themelore në territorin e saj, ose që një nga gjykatat ekzistuese themelore në territorin e komunës tjetër të ketë juridiksion mbi territorin e komunës së re. Të njëjtën të drejtë e ka edhe komuna ekzistuese, ku shumica e popullatës i takon komunitetit joshumicë në Kosovës dhe në të cilën nuk ka gjykatë themelore.

1.3.1 KGjK-ja do të miratojë kërkesat e tilla, përveç nëse vlerësohet se ngarkesa e lëndëve për atë juridiksion është e pamjaftueshme për ta arsyetuar ekzistimin e gjykatës së ndarë.

1.3.2 Kur KGjK-ja e miraton kërkesën për themelimin e gjykatës së re themelore, autoritetet kompetente do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se cilado gjykatë e re që është themeluar është funksionale brenda periudhës gjashtë mujore prej datës së vendimit.

1.3.3 Nëse KGjK nuk miraton kërkesën për krijimin e gjykatës së re themelore ose kur komuna i kërkon gjykatës ekzistuese që të ketë juridiksion për territorin e vet, autoritetet kompetente do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e qasjes në drejtësi për komunitetet lokale, e cila është vështirësuar për shkak të izolimit gjeografik, mungesës së sigurisë ose për shkak të faktorëve të tjerë relevant[. Këto masa mund të përfshijnë krijimin e një departamenti të gjykatës themelore ekzistuese në kuadër të territorit të komunës së re, prej së cilës komuna e re ka kërkuar të ketë kompetencë për territorin e vet, ose që gjykata themelore të mundësojë mbajtjen e seancave në territorin e komunës së re.

Neni 2 Gjyqtarët dhe prokurorët

2.1 Përbërja e gjyqësorit dhe prokurorisë do ta pasqyrojë shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe nevojën për përfaqësimin e barabartë proporcional të të gjitha komuniteteve, duke i dhënë rëndësi të duhur parimeve të njohura ndërkombëtare për barazinë gjinore, ashtu siç pasqyrohen në instrumentet e të drejtave të njeriut të parashikuara me nenin 2 të Aneksit I të kësaj zgjidhjeje.

2.2 Institucionet gjyqësore të Kosovës, në veçanti do të pasqyrojnë përbërjen etnike të territorit të juridiksionit të tyre. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të ndërmerë masa të nevojshme për shtimin e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga radhët e komuniteteve të Kosovës të cilët aktualisht nuk janë të përfaqësuar sa duhet në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve që shërbejnë në Kosovë dhe në çdo pjesë të saj.

2.2.1 Për përmbushjen e përgjegjësisë të veta në këtë drejtim, KGjK-ja, mes tjerash, në mesin e kandidatëve me kualifikime të barabarta për funksionin e gjyqtarit dhe të prokurorit, do t'u jep përparësi pjesëtarëve të komuniteteve të papërfaqësuar sa duhet.

2.2.2 Dhënia e përparësisë për kandidatët me kualifikime të barabarta nga komunitetet e papërfaqësuar sa duhet, do të zbatohet deri atëherë kur përqindja e gjyqtarëve dhe prokurorëve, pjesëtarë të komuniteteve joshumicë në Kosovë të jetë nën 15% dhe / ose deri atëherë kur përqindja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës të jetë nën 8%.

Neni 3 Procesi i emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve

3.1 Shqyrtimi gjithëpërfshirës, i vazhdueshëm, i njëhershëm mbarë-kosovar për përshtatshmërinë e të gjithë kandidatëve për emërime të përhershme për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë, deri në moshën e pensionimit të përcaktuar me ligj ("proces i emërimit"), do të vazhdojë të kryhet në pajtim me Urdhëresën administrative 2006 / 18¹ dhe nuk do të ndikohet nga përfundimi i mandatit të UNMIK-ut, ose me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re, ashtu siç parashikohet me nenin 15 të kësaj zgjidhjeje, përveç deri në masën e lejuar me këtë Aneks.

3.1.1 Të gjithë kandidatët e suksesshëm të cilët janë emëruar ose riemëruar për gjyqtarë dhe prokurorë nga ana e PSSP-së, si pjesë e procesit të emërimit, do të vazhdojnë të shërbejnë në postet e tyre deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre ose deri atëherë kur ata shkarkohen në pajtim me ligjin.

3.1.2 Siç parashihet me nenin 15 të kësaj zgjidhjeje, pas përfundimit të mandatit të UNMIK-ut, Komisioni i pavarur gjyqësor dhe prokurorial (KPGjP) do t'ia paraqesë me shkrim Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) rekomandimet për kandidatët për emërim dhe riemërim si gjyqtarë dhe prokurorë, i cili e ushtron pushtetin suprem që t'ia propozojë Kryetarit të Kosovës kandidatët për emërim dhe riemërim si gjyqtarë dhe prokurorë.

3.1.3 Të gjithë kandidatët e suksesshëm të cilët janë emëruar ose riemëruar nga Kryetari i Kosovës si gjyqtarë dhe prokurorë, sipas propozimit të KGjK-së si pjesë e procesit të emërimit, do të vazhdojnë të shërbejnë në këto poste deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre ose deri atëherë kur ata shkarkohen në pajtim me ligjin.

3.2 Me përfundimin e periudhës tranzitore të paraparë me nenin 15 të kësaj zgjidhjeje, përbërja KGjK-së dhe procedurat në procesin e emërimit, lidhur me implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative të sistemit të

¹ Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25 për kornizën rregullative të sistemit gjyqësor të Kosovës.

drejtësisë në Kosovë, përzgjedhja e gjyqtarëve për pozitat gjyqësore të cilat janë të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në Kosovë, do të krijohen dhe zhvillohen në pajtim me dispozitat e nenit 4 të këtij Aneksi.

Neni 4 Këshilli Gjyqësor i Kosovës

4.1 Do të jetë një Këshill Gjyqësor i Kosovës (KGjK) përgjegjës, mes tjerash, për vendimet mbi propozimet për kandidatët për funksionin e gjyqtarit, avancimin dhe transferimin e gjyqtarëve si dhe për procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve. Me ligj do të përcaktohen kompetencat dhe procedurat e KGjK-së, përfshirë këtu edhe çështjet që kanë të bëjnë me disiplinën dhe shkarkimin e anëtarëve të vet. KGjK-ja do të ketë pavarësi të plotë në kryerjen e funksioneve të veta.

4.2 KGjK-ja do të përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë.

4.2.1 Në mesin e trembëdhjetë anëtarëve pesë (5) prej tyre do të jenë anëtarë kosovarë të KPGjP-së që janë verifikuar nga KPGjP-ja si pjesë e fazës 1 dhe 2 të procesit të emërimit, në pajtim me Urdhëresën administrative 2006/18. Prej këtyre pesë anëtarëve, një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror të zgjedhur sipas metodës së rastësisë, do të shërbejnë në KGjK deri në skadimin e natyrshëm të mandateve të tyre ekzistuese, me ç'rast do të zëvendësohen me një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror të verifikuar nga KPGjP-ja dhe që janë zgjedhur nga ana e kolegëve të tyre, duke iu përmbajtur metodave të cilat kanë për qëllim sigurimin e përfaqësimit sa më të gjerë të shërbimit të gjyqësisë dhe prokurorisë. Dy (2) gjyqtarët e mbetur dhe një (1) prokuror nga radhët e pesë anëtarëve kosovarë të KPGjP-së do të shërbejnë në KGjK për një mandat plotësues njëvjeçar (1) pas skadimit të natyrshëm të mandatit të tyre, me ç'rast ata do të zëvendësohen me procedurë të njëjtë sikur edhe ish-kolegët e tyre të KPGjP-së. Në rast të themelimit të një subjekti përgjegjës për çështjet e emërimit, disiplinës dhe shkarkimit të prokurorëve, të gjithë anëtarët e mbetur të KGjK-së do të jenë gjyqtarë.

4.2.2 Nga radhët e tetë anëtarëve të mbetur, dy (2) prej tyre do të zgjidhen nga deputetët e Kuvendit të Kosovës të cilët mbajnë ulëse të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës, dy (2) anëtarë do të zgjidhen nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë ulëset e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve tjera, dhe dy (2) anëtarë do të zgjidhen nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë ulëse të fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të ulëseve. Në secilin rast, së paku një nga dy anëtarët do të jetë gjyqtar i verifikuar nga KPGjP-ja. Dy (2) anëtarë ndërkombëtarë, ku njëri prej të cilëve duhet të jetë gjyqtar do të përzgjidhen nga PCN-ja sipas propozimit të MEPSM-së.

4.2.3 Të gjithë anëtarët e KGjK-së duhet të posedojnë kualifikime relevante profesionale dhe ekspertizë të nevojshme për punën e KGjK-së.

4.3 Kandidatët për pozita gjyqësore të cilat janë të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në Kosovë, mund të propozohen për emërim vetëm nga tërë KGjK-ja, nga shumica e anëtarëve të KGjK-së të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të cilët zënë ulëse të rezervuara ose të garantuara për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në Kosovë. Nëse ky grup i anëtarëve të KGjK-së nuk e propozon kandidatin për këtë pozitë pas dy seancave të njëpasnjëshme të KGjK-së, atëherë të

gjithë anëtarët e KGjK-së do të kenë të drejtën e propozimit të kandidatit për këto pozita gjyqësore. Kandidatët do të zgjidhen nga kandidatët e kualifikuar të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara me ligj.

4.4 Kandidatët për pozitat gjyqësore për gjykatat themelore nën kompetencën e të cilave hyjnë ekskluzivisht territori i një apo më shumë komunave, ku shumica e popullsisë i takon komunitetit serb të Kosovës, mund të propozohen për emërim vetëm nga tërë KGjK-ja, nga dy anëtarët e KGjK-së të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë ulëse të rezervuara ose të garantuara për komunitetin serb në Kosovës të cilët veprojnë bashkërisht në mënyrë unanime. Nëse këta dy anëtarë nuk propozojnë kandidatë për këto pozita gjatë dy seancave të njëpasnjëshme të KGjK-së, atëherë të gjithë anëtarët e KGjK-së do ta kenë të drejtën e propozimit të kandidatëve. Kandidatët do të zgjidhen nga kandidatët e kualifikuar të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara me ligj.

4.5 Asnjë gjyqtar nuk mund të shkarkohet ose të transferohet kundër dëshirës së tij në një pozitë tjetër, përveç me propozimin e KGjK-së dhe kur këtë e parasheh Kushtetuta dhe ligji. Gjyqtari i pakënaqur me një vendim të tillë gëzon të drejtën e ankesës pranë Gjykatës Supreme.

ANEKSI V TRASHËGIMIA FETARE DHE KULTURORE

Neni 1 Emri, organizimi i brendshëm dhe prona e Kishës Ortodokse Serbe

1.1 Kishës Ortodokse Serbe (KOS) në Kosovë do t'i mundësohet mbrojtja dhe gëzimi i të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve të veta, ashtu siç parashikohet me këtë Aneks. Ushtrimi i këtyre të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve bart me vete edhe detyra dhe përgjegjësi për të vepruar në pajtim me ligjet e Kosovës dhe për të mos shkelur të drejtat e të tjerëve.

1.2 Kosova do ta njeh Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë, duke përfshirë manastiret, kishat dhe objektet tjera që shfrytëzohen për qëllime fetare si pjesë integrale e Kishës Ortodokse Serbe me seli në Beograd.

1.3 Kosova do ta respektojë emrin edhe organizimin e brendshëm të Kishës Ortodokse serbe, duke përfshirë hierarkinë dhe aktivitetet e saja.

1.4 Kosova garanton se prona e luajshme dhe e paluajshme si dhe asetet tjera të Kishës Ortodokse Serbe do të jenë të paprekshme dhe nuk do t'i nënshtrohen eksproprijimit.

1.5 Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë do të ketë liri të plotë veprimi në menaxhimin e pronës së vet, në rindërtimin e pronës dhe qasjes në objektet e veta.

1.5.1 Autoritetet e Kosovës do të kenë qasje në objektet të cilat përbëjnë pronën e Republikës së Kishës Ortodokse Serbe vetëm me pëlqimin e dhënë nga Kisha ose, në rastet kur lëshohet urdhër gjyqësor në lidhje me aktivitetet joligjore, ose në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin.

1.5.2 Kisha Ortodokse Serbe inkurajohet që popullit t'i ofrojë qasje në hapësirat e veta për të nxitur dhe promovuar kuptimin më të mirë dhe vlerësimin e rëndësisë religjioze, kulturore dhe historike.

1.6 Kosova nuk do të ndalojë në mënyrë arbitrare hyrjen në Kosovë apo banimin brenda Kosovës të priftërinjve, kandidatëve për priftëri, murgve, murgeshave, të personave laikë apo të ftuarve të tjerë dhe pjesëtarëve të Kishës Ortodokse Serbe.

1.7 Kosova do të konsultohet me Kishën Ortodokse Serbe në promovimin e trashëgimisë ortodokse serbe për qëllime turistike, shkencore, arsimore apo qëllime të tjera publike. Promovimi i tillë në tërësi do të respektojë traditat historike dhe religjioze serbe në Kosovë.

Neni 2 Përkrahja ekonomike dhe përkrahja tjetër

2.1 Kisha Ortodokse Serbe në Kosovës do të jetë e lirë të pranojë donacione dhe të përfitojë nga përkrahja tjetër nga çdo institucion brenda ose jashtë Kosovës. Këto donacione do të jepen në mënyrë plotësisht transparente.

2.2 Kosova do t'i ofrojë Kishës Ortodokse Serbe privilegje doganore dhe tatimore, krahas atyre privilegjeve të cilat i gëzojnë të gjitha fetë në Kosovë, për aktivitetet ekonomike të Kishës që janë specifike për vetëqëndrueshmërinë financiare, siç janë qëndistaria dhe veshjet fetare, qirinjtë, pikturimi i ikonave, punimet e drurit dhe zdrukthëtarisë, dhe produktet tradicionale bujqësore. Këto privilegje do të përfshijnë importimin dhe blerjen e produkteve relevante, materialeve, makinerisë dhe bagëtisë; dhe eksportimin e produkteve të cilat rezultojnë nga aktivitetet e lartpërmendura.

Neni 3 Siguria për objektet fetare dhe kulturore

3.1 Kishës Ortodokse Serbe, manastireve të saj, kishave dhe objekteve tjera fetare dhe kulturore të rëndësisë së veçantë për komunitetin serb të Kosovës, do t'u ofrohet siguria e nevojshme.

3.1.1 Përgjegjësia kryesore për të ofruar sigurinë e trashëgimisë fetare dhe kulturore të Kosovës do të bie mbi organet kosovare të zbatimit të ligjit, e në veçanti Shërbimin Policor të Kosovës (ShPK). Mbrojtja e objekteve fetare dhe kulturore serbe do të jetë detyrë e veçantë operationale e ShPK-së. Misioni i sundimit të ligjit të EPSM, në konsultim me Praninë Ushtarake Ndërkombëtare (PUN), do ta mbikëqyrë, udhëheqë dhe këshillojë ShPK-në në zbatimin e kësaj detyre.

3.1.2 Në periudhën kalimtare menjëherë pas zgjidhjes, PUN-ja do të ofrojë sigurinë për manastirin e Graçanicës, Deviçit, Zoçishtit, Arkangjelit të Shenjtë, Budisavcit, Gorioçit, Deçanit, Patrikanës së Pejës dhe monumentit memorial të Gazimestanit. Ofrimi i sigurisë për këto objekte do të vazhdojë deri atëherë kur PUN-i, pas konsultimeve me PCN-në dhe misionin e MEPSM-së, të vendosë se janë plotësuar kushtet për bartjen e këtyre përgjegjësive tek ShPK-ja.

3.1.3 Për shkallën dhe kohëzgjatjen e masave specifike për ofrimin e sigurisë fizike për këto objekte, nga ana e PUN-së do të merren parasysh, në mes tjerash i) vlerësimi i sigurisë i kryer nga PUN-i; ii) këshillat e pranuar nga Këshilli Zbatues dhe Mbikëqyrës (KZM), dhe në pajtim me nenin 5 të këtij Aneksi.

3.1.4 KZM-ja ka për qëllim ndërtimin e nivelit më të lartë të besimit dhe vetësigurisë dhe që të punojë drejt normalizimit të gjendjes së sigurisë përreth këtyre objekteve. Kapacitetet e ShPK-së do të zgjerohen sa më shpejtë që është e mundur me qëllim që PUN të ketë mundësi të lirohet nga këto detyra jo-ushtarake.

3.2 Kosova do të garantojë lirinë e lëvizjes për klerin dhe anëtarët e Kishës Ortodokse Serbe brenda Kosovës dhe, sipas nevojës, për këto lëvizje do të ofrojë masat e nevojshme të sigurisë.

Neni 4 Zonat e mbrojtura

4.1 Një numër i zgjedhur i manastireve, kishave dhe objekteve tjera fetare të Kishës Ortodokse Serbe, si dhe objektet historike dhe kulturore të rëndësisë së veçantë për komunitetin serb të Kosovës, do të gëzojnë mbrojtje të veçantë përmes përcaktimit të zonave të mbrojtura. Objektivat e zonave mbrojtëse janë: të sigurohet një ekzistim

dhe funksionim paqesor i objekteve të mbrojtura; të ruhet mjedisi historik, kulturor dhe natyral, duke përfshirë mënyrën e jetës monastike të klerit; dhe të parandalohet zhvillimi negativë përreth tyre, duke siguruar kushtet më të mira të mundshme për zhvillim harmonik dhe të qëndrueshëm të komuniteteve të cilat banojnë në hapësirat përreth këtyre objekteve. Pa prejudikuar pronësinë e pasurisë në kuadër të zonës mbrojtëse, do të zbatohen kufizimet vijuese:

4.1.1 Ndalohet çdo aktivitet i ri nga fushat vijuese:

a) Ndërtimi ose zhvillimi industrial siç është: zbulimi dhe eksploatimi i resurseve minerale; ndërtimi i pendave, i centraleve për prodhimin e energjisë ose rrjetit të energjisë elektrike, furrave dhe fabrikave, dhe rrugëve transit në viset rurale.

² Zona e mbrojtur për Manastirin e Deçanit është identike me “zonat e veçanta” të përcaktuara me Vendimin Ekzekutiv të UNMIK-ut 2005/5 të 25 prillit 2005 dhe me vendimet ekzekutive pasardhëse.

³ Kjo zonë e mbrojtur përfshin Komplexin Memorial të Isa Boletinit

b) Ndërtimi ose zhvillimi që shpie në shpyllëzimin ose ndotjen e ambientit.

4.1.2 Çdo aktivitet i ri nga fushat vijuese mund të kufizohet ashtu si e arsyetojnë rrethanat. Para kryerjes së aktiviteteve nga fushat vijuese, komuna përkatëse do të kërkojë pëlqimin e KOS. Nëse nuk arrihet marrëveshje, palët ia drejtojnë çështjen KZM-së (Këshillit Zbatues dhe Monitorues) për rishikim, në pajtim me nenin 5.4 të këtij Aneksi.²

a) Ndërtimet komerciale ose zhvillimet siç janë: ndërtesat apo godinat më të gjata se manastiri/kisha/monumenti kulturor që duhet mbrojtur, rrugët/rrugicat, ndërtimet, ndërtimi i depove, punëtorive, dyqaneve, restoranteve, bareve, kafiterive, hoteleve/moteleve, kiosqeve dhe stendave të ushqimit, popave të benzinit dhe qendrave për riparimin e automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës dhe çdo ndërtim në përmasa më të mëdha nëpër rajonet rurale;

b) Tubimet publike, rekreative dhe zbavitëse;

c) Urbanizimi i tokës bujqësore.

4.1.3 Kosova do të sigurojë që planet hapësinore për rajonet brenda zonave të mbrojtura të jenë në pajtim me kufizimet e përcaktuara në 4.1.1 dhe 4.1.2

4.1.4 Zonat e mbrojtura për lokacionet vijuese do të përcaktohen me hartat e bashkëngjitura:

Manastiri i Deçanit/Deçan 2

Patrikana e Pejës/Pejë

Manastiri i Graçanicës/Prishtinë

Kisha e Shpalljes së Virgjëreshës/Lipjan

Manastiri i Deviçit/Skenderaj

Manastiri i Gorioçit/Istog

Manastiri i Budisavcit/Klinë

² Në rast të ndonjë aktiviteti të tillë brenda zonës mbrojtëse për hapësirat vijuese, komuna përkatëse drejtpërsëdrejti konsultohet me KM: Monumenti memorial në Gazimestan, Kështjella mesjetare në Zveçan, qyteti mesjetar në Novo Bërd dhe Ura mesjetare Vojnovic/Ura e vjetër.

Manastiri i Sokolicës/Zveçan 4³

Manastiri i Draganacit/Gjilan
Manastiri i Arkangjelit të Shenjtë/Prizren
Manastiri i Banjskës/Zveçan
Manastiri i Zoqishtës, Zoqishtë/Rahovec
Fshati Hoqë e Madhe/Rahovec
Manastiri Duboki Potok/Zubin Potok
Kisha e Shën Gjergjit, Gornjasellë/Prizren
Manastiri i Soçanicës/Leposaviq
Kisha e Hermitëve, Uljaricë/Klinë
Monumenti memorial i Gazimestanit/Obiliq 4
Kështjella Mesjetare e Zveçanit/Zveçan
Qyteti Mesjetar i Novobërdës/Novobërdë
Ura Mesjetare e Vojnoviqëve/Vushtrri
Vetmia e Petrit të Shenjtë, Korishë, Prizren

4.1.5 Zona e mbrojtur për objektet vijuese do të përkufizohet në 100 metra hapësirë rreth perimetrit të tyre:

Manastiri i Premtit të Shenjtë, Leposaviq
Manastiri i Shëruesve të Shenjtë, Leposaviq
Manastiri i Virgjëreshës së Shenjtë të Hvosnos, Skenderaj
Manastiri i Markut të Shenjtë, Korishë, Prizren
Manastiri i Treshit të Shenjtë, Mushtisht, Suharekë
Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, Sredskë, Prizren
Manastiri i Uroshit të Shenjtë, Nerodime, Ferizaj
Manastiri i Binaçit, Buzovik, Viti

4.1.6 Zona e mbrojtur për objektet vijuese do të përkufizohet në 50 metra hapësirë rreth perimetrit të tyre:

Manastiri i Dollacit, Klinë
Kisha e Shën Nikollës, Gjurakoc, Istog
Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë në Hodegetri, Mushtisht, Suharekë
Kisha e Nikollës së Shenjtë, Shtërpçë
Kisha e Teodorit të Shenjtë, Biti e Poshtme, Shtërpçë
Kisha e Nikollës së Shenjtë, Gotovushë, Shtërpçë

³ Zona mbrojtëse për Manastirin e Deçanit është identike me hapësirën e zonës së veçantë, ashtu siç është përkufizuar në Vendimin ekzekutiv të UNMIK-ut 2005/5 të datës 25 prill 2005 dhe të vendimeve të mëvonshme ekzekutive.

⁴ Zona mbrojtëse është zonë e përbashkët mbrojtëse për Manastirin e Sokolicës dhe Kompleksin Memorial Isa Boletini. Komuna në fjalë duhet të kërkojë pëlqimin edhe nga KOS edhe nga Administrata e Muzeut të Isa Boletinit për çfarëdo aktiviteti të ri të paraparë në nenin 4.1.2 të këtij Aneksi

⁵ Rekomandohet që Tyrbja e Bajraktarit të përfshihet nën zonën e njëjtë të mbrojtur, që kjo e fundit më vonë të zgjerohet në mënyrë të përshtatshme ose të krijohet një zonë e veçantë e mbrojtur për këtë monument. Gjithashtu rekomandohet që të krijohet zonë e mbrojtur edhe për mauzoleun e Sulltan Muratit.

Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, Gotovushë, Shtërpçë
Kisha e Shën Gjergjit, Biti e Epërme, Shtërpçë
Kisha e Nikollës së Shentjës, Mushnikovë, Prizren
Kisha e Nikollës së Shentjës, Bogoshevc, Prizren
Kisha e Nikollës së Shentjës, Drajçiq, Prizren
Kisha e Nikollës së Shentjës, Sredskë, Prizren
Kisha e Apostujve të Shenjtë (ose Premtit të Shenjtë), Mushnikovë, Prizren
Kisha e Shën Gjergjit, Serdskë, Prizren

4.1.7 Zona e mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të përcaktohet nga organet komunale të Prizrenit në bashkëpunim me KZM-në dhe do të përfshijë objektet e Kishës Ortodokse, objektet otomane, katolike, laike dhe objektet tjera të rëndësishme të veçantë historike dhe kulturore. Objektet kulturore dhe fetare serbe vijuese do të përfshihen në zonë të mbrojtur: Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë e Levishës; lagja e vjetër “mëhalla Marash”; Kisha e Shpëtimtarit të Shenjtë; Shkolla Ortodokse për Priftërinj e Kirilit dhe Metodit të Shenjtë; dhe Rezidenca Episkopike me Kishën e Shën Gjergjit.

4.2 Fshati Hoqë e Madhe do ta ketë të drejtën që, në konsultim me komunën e Rahovecit, të ushtrojë autorizime të kufizuara në aktivitetet nga fusha e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë fetare dhe kulturore dhe nga fusha e planifikimit rural në lidhje me zonat e mbrojtura, në pajtim me nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000 / 45 për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës. Këshilli zbatues dhe mbikëqyrës (KZM) do t'i lehtësojë këto konsultime në pajtim me nenin 5.4 të këtij Aneksi.

Neni 5 Këshilli zbatues dhe mbikëqyrës

5.1 Do të themelohet Këshilli zbatues dhe mbikëqyrës (KZM) dhe ai do të takohet rregullisht për të mbikëqyrur dhe lehtësuar zbatimin e dispozitave të kësaj zgjidhjeje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë.

5.2 KZM-ja do të kryesohet nga një zyrtar i lartë ndërkombëtar i cili do të caktohet nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) i Kosovës.

5.3 Përveç kryesuesit, KZM-ja do t'i ketë shtatë (7) anëtarë tjerë. Në KZM do të shërbejnë përfaqësuesit e institucioneve vijuese: Ministria e Kulturës e Kosovës, Institucioni për Mbrojtjen e Monumenteve në Prishtinë, Kisha Ortodokse Serbe, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve në Leposaviq, OSBE-ja, Këshilli i Evropës dhe UNESCO.

5.4 KZM -ja do të:

- a) Këshillojë dhe paraqesë rekomandime për PCN-në lidhur me zbatimin e dispozitave të zgjidhjes e që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë;
- b) Mbikëqyrë përkufizimin e zonave të mbrojtura në terren dhe zbatimin e tyre;
- c) Rekomandojë ndryshimet në kufijtë administrativ të zonave të mbrojtura dhe zbatojë kufizimet atëherë kur këto t'i arsyetojnë rrethanat;

- d) Ndërmjetësojë zgjidhjen e kontesteve midis Kishës Ortodokse Serbe dhe autoriteteve qendrore dhe lokale të Kosovës, në lidhje me zbatimin e dispozitave të këtij Aneksi, dhe të sigurojë rekomandime relevante për veprime që duhet të ndërmerren nga PCN sipas nevojës;
- e) Rekomandojë PCN-së masa për korrigjimin e mangësive të mundshme në zbatimin e dispozitave të zgjidhjes që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë;
- f) Këshillojë organet e Kosovës për zbatimin e ligjit, Pranimë Ushtarake Ndërkombëtare dhe Misionin e EPSM-së lidhur me çështjet e sigurisë të cilat ndikojnë në objektet e trashëgimisë fetare dhe kulturore.

5.5 KZM-ja do të mbështetet nga sekretariati i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin e përditshëm të zbatimit të këtij Aneksi, dhe do të përbëhet nga personeli ndërkombëtar dhe vendor të cilët i raportojnë drejtpërsëdrejti kryesuesit.

5.6 Autoritetet e Kosovës dhe Serbisë do të veprojnë në përputhje me mekanizmin e tanishëm të restaurimit të objekteve të Kishës Ortodokse Serbe, me Komisionin për realizimin e rindërtimit ose me pasardhësin e tij.

5.7 KZM do të punojë ngushtë me Komisionin për zbatimin e rindërtimit ose me pasardhësin e tij në çështjet e ruajtjes dhe rindërtimit të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe.

Neni 6 Kthimi i artefakteve arkeologjike dhe etnologjike

6.1 Republika e Serbisë, brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje, do t'i kthejë artefaktet arkeologjike dhe etnologjike të cilat janë marrë hua nga muzetë e Kosovës për ekspozim të përkohshëm në Beograd gjatë viteve 1998-1999.

6 Kompleksi i Rezidencës Episkopike përfshin rezidencën e Peshkopit, Katedralen e Shën Gjergjit, kishën e Shën Gjergjit (Runoviç) dhe Shën Nikollën (Tutic).

ANEKSI VI BORXHI I JASHTËM

Neni 1 Dispozitat e përgjithshme

1.1 Kosova do të merr përsipër pjesën e vet të borxhit të jashtëm të Republikës së Serbisë. Pjesa e Kosovës do të përcaktohet përmes negociatave ndërmjet Kosovës dhe Republikës së Serbisë, duke pasur parasysh parimet vijuese, në marrëveshje me kreditorët relevantë: borxhi i caktuar i jashtëm do të jetë detyrim i Kosovës kur përfituesi përfundimtar është i vendosur në Kosovë; borxhi i jashtëm i papërcaktuar do t'ju ndahet palëve sipas një çelësi proporcional, i cili do të caktohet me marrëveshjen ndërmjet palëve, në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Neni 2 Detyrimi për pagimin e borxhit

2.1. Përderisa borxhi nuk është barazuar plotësisht dhe nuk është rindarë në marrëveshje me kreditorët, Republika e Serbisë në pajtim me përgjegjësitë e veta si huamarrëse/ garantuese sovrane, do të sigurojë vazhdimësinë e pagimit të borxhit. Kosova do t'i kompensojë Republikës së Serbisë pjesën e caktuar në mënyrë të rregullt të pagimit të borxhit të cilin Republika e Serbisë e ka paguar në pritje të kompletimit të procesit të përmbushjes së borxhit.

Neni 3 Arbitrazhi

3.1. Nëse brenda gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhjeje, Kosova dhe Republika e Serbisë nuk janë pajtuar për barazimin dhe ndarjen e borxheve, Grupi drejtues ndërkombëtar, pas konsultimit me palët, do të emërojë një arbitër ndërkombëtar për ndarjen e borxhit të jashtëm të Republikës së Serbisë në mes të Republikës së Serbisë dhe Kosovës ose atë pjesë të borxhit të jashtëm për të cilin nuk është arritur ujdi nga palët, në marrëveshje me kreditorët relevantë.

3.2. Caktimi i borxhit nga arbitri do të jetë i përvokueshëm dhe ai do të vendosë se cilat borxhe do t'i transferohen Kosovës që ajo t'i merr përsipër.

⁵ UNMIK-u do të nxjerr një rregullore ose urdhëresë administrative gjatë periudhës tranzitore, me të cilën do të transferohen të drejtat pronësore dhe obligimet e ndërlidhura të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, dhe do të përcaktohen të drejtat pronësore dhe obligimet e ndërlidhura për NSH-të individuale ndërmjet nivelit qendror dhe komunave të caktuara në përputhje me nenin 1.1. të këtij Aneksi. Kjo rregullore ose urdhëresë administrative hyn në fuqi menjëherë pas periudhës tranzitore.

⁶ UNMIK-u do të nxjerr një rregullore për themelimin e institucionit pasardhës të AKM-së gjatë periudhës tranzitore, e cila do të përfshijë dispozitat nga neni 2 i këtij Aneksi dhe parimet përcjellëse. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas periudhës tranzitore.

- Prona private do të mbrohet në tërësi sipas parimeve të KEDNJ;
- Procesi i privatizimit i NSH-ve do të vazhdojë të kryhet me transparencë nga institucioni pasardhës i AKM-së, me pjesëmarrjen përkatëse ndërkombëtare;
- Do të vazhdojë të zbatohet parimi i kompensimit në vend të kthimit fizik. Rregullat e detajuara mbi metodën e përcaktimit të kompensimit të tillë do të përfshihen në legjislacionin kosovar, të cilat do të marrin për bazë standardet relevante të KEDNJ-së;

- Procesi i likuidimit të ndërmarrjeve të privatizuara dhe aseteve do të vazhdojë të kryhet me transparencë nga komisionet e pavarura të likuidimit të emëruara nga institucioni pasardhës i AKM-së;
- Përcaktimi përfundimtar i pronësisë dhe shqyrtimi i ankesave do të vazhdojë të kryhet nga mekanizmi i Dhomës së Posaçme pranë Gjykatës Supreme, në përputhshmëri me nenin 3 të këtij Aneksi;
- Fondi i mirëbesimit i AKM-së i përbërë nga mjetet e privatizimit apo likuidimit do të ruhet për të përmbushur kërkesat valide të kreditorëve dhe ankesat mbi pronësinë. Këto fonde do të shfrytëzohen për investime, sipas investimeve të klasifikuara nga agjencitë ndërkombëtare për klasifikim;
- Pas skadimit të çdo periudhe kohore për dorëzimin e një kërkesë të tillë dhe pas përmbushjes së të gjitha kërkesave valide të kreditorëve dhe të atyre mbi pronësinë – brenda kufijve të fondeve në dispozicion për secilin rast – fondet e mbetura të AKM-së (prona shoqërore dhe mjetet e grumbulluara nga procesi i privatizimit dhe likuidimit të pronës shoqërore) do të transferohen në Qeverinë e Kosovës.

ANEKSI VII PRONA DHE ARKIVI

Neni 1 Ndërmarrjet publike

1.1. Të drejtat e pronësisë në ndërmarrjet publike (NP) dhe obligimet e ndërlidhura, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në detyrimet para korporatizimit, do t'i transferohen Kosovës. Të drejtat e pronësisë dhe obligimet e ndërlidhura të NP-ve të cilat ofrojnë shërbime vetëm në ndonjë komunë specifike apo në numër të kufizuar të komunave, posaçërisht në fushën e furnizimit me ujë, hedhurinave, ujitjes dhe ngrohjes do t'i transferohen asaj komune ose komunave përkatëse.⁷ Kosova do të respektojë standardet evropiane lidhur me menaxhimin e ujit, menaxhimin e hedhurinave dhe mbrojtjen e ambientit.

1.2. Pavarësisht nga këto të drejta pronësore, organet kompetente të Kosovës marrin masa të duhura për implementimin e parimeve relevante ndërkombëtare për qeverisjen dhe liberalizimin e korporatave. Masat e theksuara më lart do të përjashtojnë posaçërisht rikthimin e statusit të NP-ve të inkuorpuara si shoqëri aksionare dhe strukturave qeverisëse të korporatës të cilat janë zbatuar brenda tyre.

Neni 2 Ndërmarrjet shoqërore

2.1. Administrimi i ndërmarrjeve shoqërore (NSH) dhe aseteve të tyre do të ushtrohet nga institucioni i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) ashtu siç është paraparë në Rregulloren e ndryshuar të UNMIKU-ut 2001/12.^{8 6} Zgjidhja e ankesave do të bëhet në pajtim me dispozitat e parapara në nenin 3 të këtij Aneksi.

2.2. Me qëllim të monitorimit, posaçërisht të përputhshmërisë me parimet e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe me legjislacionin përkatës të privatizimit dhe likuidimit të NSH-ve PCN emëron:

- a. Tre (3) anëtarë ndërkombëtarë të Bordit të drejtorëve të institucionit pasardhës të AKM-së;
- b. Drejtorin e sekretariatit ekzekutiv të Bordit të drejtorëve të institucionit pasardhës të AKM-së;
- c. Një (1) anëtar nga secili komision i likuidimit.

2.3. Anëtarët ndërkombëtarë të Bordit të drejtorëve kanë kompetenca, që duke vepruar bashkarisht dhe unanimisht, të pezullojnë vendimin e institucionit pasardhës të AKM-së nëse ata gjejnë se një vendim i tillë është në kundërshtim me parimet e KEDNJ-së dhe Protokolleve të saj dhe ligjit në fuqi, dhe çështjen t'ia drejtojnë Dhomës së Posaçme pranë Gjykatës Supreme për të marrë vendim. Për raste të tilla, Dhoma e Posaçme vendos me urgjencë.

2.4. Për çdo pagesë individuale nga mjetet e privatizimit dhe likuidimit të grumbulluara në fonde të mirëbesimit, kërkohet pajtimi i anëtarëve ndërkombëtarë të bordit të drejtorëve, të cilët veprojnë bashkarisht dhe unanimisht, përveç nëse Dhoma e Posaçme ka lëshuar vendim për pagesat që duhet bërë.

2.5 Dy donatorët më të mëdhenj ndërkombëtarë të institucionit pasardhës të AKM-së kanë të drejtë të marrin pjesë në takimet e Bordit të drejtorëve të institucionit pasardhës të AKM-së në cilësinë e vëzhguesve.

Neni 3 Procesi i shqyrtimit të kërkesave në AKM

3.1. Caktimi përfundimtar i pronësisë dhe shqyrtimi i kërkesave do të vazhdojë të bëhet nga Dhoma e Posaçme në Gjykatën Supreme, e themeluar për këtë qëllim me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13.

3.2. Në Dhomën e Posaçme do të jenë pesë kolegje të specializuara për të shqyrtuar fushat e kompetencave vijuese: (i) kërkesat mbi privatizimin; (ii) kërkesat mbi listat e punëtorëve; (iii) kërkesat mbi pronësinë e përgjithshme dhe ato të kreditorëve; (iv) kërkesat mbi likuidimin; (v) kërkesat e riorganizimit të ndërmarrjes. Secili kolegji i specializuar përbëhet nga dy (2) gjyqtarë ndërkombëtarë dhe një gjyqtar kosovar.

- Vendimi përfundimtar mbi pronësinë dhe zgjidhja e ankesave do të vazhdojë të trajtohet nga një mekanizëm i Dhomës së Posaçme brenda Gjykatës Supreme, në pajtim me nenin 3 të këtij Aneksi;
- Fondet e Trustit të AKM-së ku përfshihet pasuria e fituar nga privatizimi dhe likuidimi do të ruhen në mënyrë që të përmbushin kërkesat valide të kreditorëve dhe pronarëve. Këto fonde do të shfrytëzohen për investime, sipas shkallës së investimeve të vlerësuar nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit.
- Pas skadimit të afatit për dorëzimin e ankesave të tilla, dhe plotësimin e të gjitha kërkesave valide të kreditorëve dhe pronarëve – në kuadër të kufizimeve të fondeve që janë në dispozicion për secilin rast- pjesa e mbetur e fondeve të AKM-së (prona shoqërore dhe pasuria nga privatizimi/likuidimi i pronës shoqërore) do t'u transferohet Qeverisë së Kosovës.

3.3. Pranë Dhomës së Posaçme është kolegji i apelit për shqyrtimin e vendimeve të Dhomës së Posaçme. Kolegji i apelit përbëhet nga tre (3) gjyqtarë tjerë ndërkombëtarë dhe dy gjyqtarë kosovarë.

Neni 4 Agjensioni Kosovar i Pronës (AKP)

4.1. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 për shqyrtimin e kërkesave të pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, vazhdon të jetë në fuqi dhe të zbatohet në përputhshmëri me dispozitat e kësaj zgjidhjeje. Shqyrtimi i rasteve pronësore do të përfundohet deri më 31 dhjetor 2007, me qëllim kompletimit të zbatimit të vendimeve jo më vonë se 31 dhjetor 2008.

4.2. Postet në vijim do të plotësohen nga përfaqësuesit ndërkombëtarë sipas emërimit nga PCN-ja:

- a. Tre (3) anëtarë ndërkombëtarë të Bordit Mbikëqyrës, duke përfshirë edhe kryesuesin e tij;
- b. Drejtori i Sekretariatit Ekzekutiv;
- c. Dy (2) anëtarë ndërkombëtarë të Komisionit për shqyrtimin e ankesave, duke përfshirë edhe kryesuesin e tij;
- d. Dy (2) gjyqtarë ndërkombëtarë në përputhshmëri me nenin 5 të këtij Aneksi

Neni 5 Procesi i shqyrtimit të ankesave në AKP

5.1. Ankesat kundër vendimeve të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të AKP-së vendosen nga kolegjet prej tre gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të përbëra prej dy (2) gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe një (1) gjyqtari vendor.

5.2. Posedimi i paligjshëm i pasurisë së paluajtshme private nuk jep të drejta pronësore. Nëse parashtruesi i ankesës mund të vërtetojë se nuk ka pasur qasje në institucionet relevante për dorëzimin e një ankese sipas afatit të paraparë, në mënyrë që ajo të trajtohet në kuadër të afatit të paraparë, ankesa e tillë nuk do të konsiderohet se nuk është pranuar nga gjykata kompetente apo nga organi tjetër gjyqësor apo gjoja gjyqësor.

5.3. Në konsultim me PCN-në Kosova do të zbatojë masa shtesë për të siguruar që procesi i shqyrtimit për kthimin/kompensimin e kërkesave pronësore të jetë efikas dhe vendimet të zbatohen në mënyrë efektive.

Neni 6 Kthimi i pronës

6.1. Kosova gjithashtu do të trajtojë çështjet e kthimit të pronës, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me Kishën Ortodokse Serbe, si çështje me prioritet. Kosova do të krijojë mekanizma të pavarur për formulimin e politikave, kornizave legjislative dhe institucionale për trajtimin e çështjeve të kthimit të pronës. Përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar ftohen për të marrë pjesë në mekanizma të tillë, të cilët përfshijnë përfaqësues të komuniteteve joshumicë.

Neni 7 Arkivi

7.1. Arkivi, duke përfshirë regjistrat kadastral dhe dokumentet e lidhura me Kosovën dhe banorët e saj të cilat janë zhvendosur nga Kosova, do të kthehen në Kosovë. Pjesët e arkivit shtetëror të Republikës së Serbisë, të nevojshme për administrim normal të Kosovës do të transferohen në Kosovë sipas parimit të rëndësisë funksionale, pavarësisht se ku ka qenë apo është i vendosur arkivi.

7.2. Republika e Serbisë do të kthejë apo transferojë të gjithë arkivat brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje. Derisa arkivi të jetë kthyer apo transferuar, Republika e Serbisë do të lejojë qasje të lirë, të papenguar dhe efektive në të.

ANEKSI VIII SEKTORI I SIGURISË SË KOSOVËS

Neni 1 Siguria e Kosovës

1.1.Përveç aty ku është specifikuar në këtë zgjidhje, Kosova do të ketë kompetenca mbi zbatimin e ligjit, sigurisë, drejtësisë, sigurisë publike, inteligjencës, organeve civile emergjente dhe kontrollit të kufijve në territorin e saj.

1.2.Institucionet e sigurisë në Kosovë do të operojnë në përputhshmëri me standardet demokratike dhe të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, ashtu siç është paraparë në Aneksin II.

1.3.Kosova do të themelojë një komision parlamentar për mbikëqyrje të sektorit të sigurisë në përputhshmëri me këtë zgjidhje.

1.4.Kosova do të themelojë Këshillin e Sigurisë së Kosovës (KSK) i cili i raporton Kryeministrit. KSK zhvillon strategjinë e sigurisë në përputhshmëri me këtë zgjidhje. Kosova do të hartojë kornizë legjislative mbi komponentët e sektorit të sigurisë në përputhshmëri me këtë zgjidhje, me dispozita të duhura buxhetore dhe të mbikëqyrjes.

1.5.Në ato fusha të sektorit të sigurisë ku vazhdon përfshirja ndërkombëtare në përputhshmëri me këtë zgjidhje, Kosova në bashkëpunim me PCN-në dhe PUN-në, me kohë do të zhvillojë strategji për transferim të plotë të përgjegjësisë tek autoritetet kosovare.

1.6.Procesi i zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë do të jetë plotësisht transparent ndaj fqinjve të Kosovës, dhe Kosova do të krijojë masa të duhura të ndërlidhjes dhe ndërtimit të besimit me homologët e saj rajonal.

1.7.Kosova do të përmbushë standardet e OKB-së, OSBE-së dhe BE-së dhe praktikat në fushën e sigurisë dhe kontrollit të armëve si dhe marrëveshjet tjera rajonale dhe deklaratat nën fushëveprimin e OSBE-së.

Neni 2 Policia

2.1. Në tërë Kosovën do të ruhet një zinxhir i unifikuar i komandës së shërbimeve policore.

2.2. Kufijtë e stacioneve policore rajonale do të jenë të njëjta me kufijtë komunal.

2.3. Përbërja etnike e policisë brenda komunës do të reflektojë, për aq sa të jetë e mundshme, përbërjen etnike të popullatës në komunë.

2.4 Këshillat e përbërë nga përfaqësuesit komunal dhe të policisë duke përfshirë edhe komandantët e stacioneve do të bëhen plotësisht funksional në mënyrë që të lehtësojnë

bashkëpunimin në mes të Shërbimit Policor dhe autoriteteve komunale/udhëheqësve lokal të komunitetit. Këshillat udhëhiqen nga kryetarët e komunave.

2.5. Komandantët e stacioneve lokale paraprakisht informohen për operacionet nga forcat policore qendrore apo speciale brenda perimetrit të stacioneve policore lokale, përveç nëse sipas kërkesave operacionale kërkohet ndryshe.

2.6. Në komunat me shumicë serbe në Kosovë, komandantët e stacioneve lokale zgjedhen sipas procedurës vijuese: Kuvendi komunal propozon së paku dy emra për komandant stacioni të cilët i përmbushin kërkesat minimale të profesionit, ashtu siç është paraparë në legjislacionin e Kosovës. Ministria e Punëve të Brendshme mund të emërojë një kandidat nga kjo listë brenda 15 ditëve nga pranimi i listës. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk pranohen nga Ministria, kuvendi komunal do të sigurojë listën e dytë me së paku dy kandidatë të ndryshëm për shqyrtim nga Ministria, të cilët janë nga radhët ekzistuese të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të cilët përmbushin të gjitha kërkesat minimale të profesionit, ashtu siç kërkohet nga legjislacioni i Kosovës. Pastaj, Ministria obligohet që të emërojë një kandidat nga lista e dytë brenda 15 ditëve nga pranimi i saj.

Neni 3 Kufiri

3.1. Kosova në bashkërendim me PCN-në dhe PUN-në zhvillon një strategji për mundësimin e dorëzimit të përgjegjësive mbi kontrollin e kufijve dhe udhëheqjes së tyre të asociuar dhe të integruar në Shërbimin Policor të Kosovës sipas fazave të parapara.

3.2. Territori i Kosovës do të përkufizohet nga vija kufitare e Krahinës Socialiste Autonome e Kosovës brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ashtu siç kanë qenë këto vija kufitare më 31 dhjetor 1988, përveç ndryshimit të vijës kufitare nga marrëveshja e demarkacionit në mes të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë më 23 shkurt 2001.⁹

3.3. Kosova do të angazhohet me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për themelimin e një komisioni të përbashkët teknik brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj zgjidhjeje, për të përkufizuar vijën fizike të kufirit dhe për trajtimin e çështjeve tjera që dalin nga zbatimi i marrëveshjes së vitit 2001 në mes të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Puna e komisionit teknik do të përfundojë brenda një viti nga data e themelimit të tij. PCN dhe PUN do të përfaqësohen në këtë komision për të lehtësuar diskutimet në mes të dy palëve dhe ata mund të marrin pjesë në procesin e demarkacionit të kufirit me kërkesë të cilësdo palë.

⁹ Në deklaratën e tij të 7 marsit 2001, kryesuesi i Këshillit të Sigurimit, ndër të tjera përmendi: "Këshilli i Sigurimit bën thirrje për nevojën e respektimit të sovranitetit dhe integritetit territorial të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në këtë kontekst thekson se marrëveshja mbi demarkacionin e kufirit, e nënshkruar në Shkup më 23 shkurt 2001... duhet të respektohet nga të gjithë."

Neni 4 Shërbimet e inteligjencës

4.1. Kosova do të themelojë një agjencion vendor të sigurisë për të mbikëqyrur kërcënimet ndaj sigurisë së brendshme në Kosovë në përputhshmëri me Aneksin IX.

Ky agjencion do të jetë profesional, apolitik, shumetnik dhe nën mbikëqyrje të Parlamentit dhe administratës civile.

Neni 5 Forca e Sigurisë së Kosovës

5.1 Në Kosovë do të themelohet një Forcë e re e Sigurisë (FSK) e cila do të jetë profesionale dhe shumetnike. Ajo nuk do të krijojë një barrë të panevojshme financiare për resurset e Kosovës. Qeveria do të themelojë një organizatë civile për të siguruar një kontroll civil mbi FSK-në, në përputhshmëri me anekset IX dhe XI.

5.2. FSK-ja do të jetë e armatosur lehtë dhe nuk do të posedojë armë të rënda si tanke, artileri të rëndë apo kapacitet ajror ofanziv. FSK-ja do të përbëhet prej jo më tepër se 2500 pjesëtarëve aktiv dhe 800 pjesëtarëve rezervë.

5.3 Ndryshimet ndaj kufizimeve të përcaktuara në nenin 5.2 të këtij Aneksi do të përcaktohen nga PUN-ja, në bashkërendim me PCN-në. Një shqyrtim i plotë i këtyre kufizimeve do të bëhet jo më herët se 5 vite nga data e hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhjeje.

5.4. Fillimisht, FSK-ja do të jetë kryesisht përgjegjëse për përgjigjen ndaj krizave, asgjësimin e mjeteve eksplozive dhe mbrojtjen civile. Gjithashtu, FSK-ja do të konstruohet dhe përgatitet për përmbushjen e funksioneve tjera të sigurisë, të cilat nuk janë të përshtatshme për policinë apo organizatat tjera të zbatimit të ligjit. PUN-ja në bashkërendim me PCN-në do të themelojnë një proces të standardizuar të monitorimit me qëllim të përcaktimit se kur do të autorizojnë FSK-në për angazhim në këto funksione të sigurisë.

5.5. Pjesëtarët e FSK-së do të rekrutohen nga gjithë shoqëria. Një procedurë formale e përzgjedhjes do të zhvillohet nga Kosova së bashku me PUN-në. Rekrutimi do të fillojë menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj zgjidhjeje në mënyrë që të sigurohen aftësitë fillestare operationale brenda një viti nga përfundimi i periudhës së tranzicionit, ashtu siç është paraparë në nenin 15 të kësaj zgjidhjeje.

5.6. Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare do të bëjnë përpjekje të përbashkëta për të pajisur FSK-në pasi të jenë siguruar fondet dhe burimet. Kosova do ta njoftojë PUN-në për të gjitha burimet, fondet dhe pajisjet e siguruar për FSK-në nga jashtë.

Neni 6 Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK)

6.1. TMK-ja do të shpërbëhet pasi t'i ketë përmbushur objektivat e veta, duke përfshirë edhe mundësimin e rimëkëmbjes së Kosovës pas konfliktit. PUN-ja, në konsultim me PCN-në dhe Kosovën, do të ushtrojë mbikëqyrje ekzekutive të TMK-së dhe do të vendosë për kohën e shpërbërjes së saj. Shpërbërja do të bëhet brenda një viti nga përfundimi i periudhës së tranzicionit, ashtu siç është paraparë në nenin 15 të

kësaj zgjidhjeje. Bashkësia ndërkombëtare do të zhvillojë një proces për çmobilizimin dhe i riintegrimin e pjesëtarëve të TMK-së që do të pensionohen.

Neni 7 Kontrolli i hapësirës ajrore

7.1. Kosova do të merr përsipër pronësinë, përgjegjësinë dhe llogaridhënien e plotë për hapësirën e saj ajrore. Kosova do të themelojë Autoritetin Civil të Aviacionit (ACA) për të rregulluar veprimtaritë e Aviacionit Civil në Kosovë, dhe PUN-ja do të ketë të drejtë të rivendosë kontroll ushtarak ndaj hapësirës ajrore, ashtu siç është paraparë në nenin 2 të Aneksit XI. ACA gjithashtu do të caktojë një kompani për shërbimet e lundrimit ajror.

ANEKSI IX PËRFAQËSUESI CIVIL NDËRKOMBËTAR

Neni 1 Objektivat

1.1 Kosova do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e çështjeve të veta bazuar në parimet demokratike të sundimit të ligjit, përgjegjshmërinë e Qeverisë dhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, të drejtave të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve dhe mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve të saj. Duke ditur se përmbushja e përgjegjësisë që i janë caktuar Kosovës sipas kësaj zgjidhjeje kërkon zhvillimin e një sërë veprimtarishë të ndërlikuara dhe të rënda, një Përfaqësues Civil Ndërkombëtar (PCN) do ta mbikëqyrë zbatimin e kësaj zgjidhjeje dhe do t'i mbështesë përpjekjet relevante të autoriteteve të Kosovës.

Neni 2 Mandati dhe pushteti i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar

2.1 Sa i përket mbikëqyrjes së përgjithshme të zbatimit të kësaj zgjidhjeje, PCN-ja do të:

a. ketë pushtetin suprem në Kosovë sa i përket interpretimit të aspekteve civile të kësaj zgjidhjeje;

b. sigurojë zbatimin efektiv të kësaj zgjidhjeje përmes ekzekutimit të detyrave specifike që i janë caktuar PCN-së në pjesët tjera të kësaj zgjidhjeje;

c. ndërmarrë masa korigjuese për ta përmirësuar, sipas nevojës, çdo veprim që ndërmerret nga autoritetet e Kosovës, që PCN-ja konsideron se përbën shkelje të kësaj zgjidhjeje, se e rrezikon seriozisht sundimin e ligjit apo se, në ndonjë mënyrë tjetër, bie ndesh me kushtet dhe frymën e kësaj zgjidhjeje. Masat e tilla korigjuese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në anulimin e ligjeve apo të vendimeve që miratohen nga autoritetet e Kosovës;

d. në rastet e dështimeve serioze apo të vazhdueshme në vënien në jetë të thelbit apo frymës së kësaj zgjidhjeje dhe në rast të pengesave serioze në punën e PCN-së dhe MEPSM-së, PCN-ja do ta ketë autorizimin ta sanksionojë apo largojë nga detyra çdo zyrtar publik apo të ndërmarrë masa të tjera, sipas nevojës, për ta siguruar respektimin e plotë të kësaj zgjidhjeje;

e. mbikëqyrë, nëpërmjet zyrës së tij apo nëpërmjet krijimit të mekanizmave të duhur raportues nga akterët dhe organizatat e tjera ndërkombëtare që mund të jenë të pranishme në Kosovë, implementimin e të gjitha aspekteve civile të kësaj zgjidhjeje.

2.2 Krahas autorizimit të tij për të emëruar, siç është përcaktuar në pjesët tjera të kësaj zgjidhjeje, PCN-ja do ta ketë autorizimin e emërimit të drejtpërdrejtë apo dhënies së pëlqimit për emërimin e posteve si vijon:

- a. Revizori i përgjithshëm do të jetë ndërkombëtar që do të emërohet nga PCN-ja.
- b. Pas skadimit të mandatit të anëtarëve ndërkombëtarë të tanishëm të Bordit të Drejtorëve të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPT), PCN-ja do ta emërojë një përfaqësues ndërkombëtar si anëtar të Bordit të Drejtorëve të TKPT-së.
- c. Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë do të përzgjedhen nga MEPSM-ja për emërimin e të cilëve do të kërkohet pëlqimi i PCN-së para emërimit të tyre;
- d. Drejtori i përgjithshëm i shërbimit të doganës, drejtori i administratës tatimore, drejtori i thesarit dhe drejtori menaxhues i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës (AQBK) do të emërohen nga autoritetet kompetente për emërim, pas marrjes së pëlqimit nga PCN-ja;
- e. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij për emërim, PCN-ja do t'i marrë parasysh kualifikimet profesionale të kandidatëve, reputacionin e integritetit të tyre dhe do të zbatojë ligjin në mënyrë të paanshme dhe strikte.

2.3 Pushteti dhe kompetencat e PCN-së dhe pushteti dhe kompetencat e PSBE-së do t'i mvishen të njëjtit person. PSBE-ja do t'i ketë kompetencat vijuese në fushën e sundimit të ligjit, duke përfshirë, në veçanti, gjyqësorin, policinë, kontrollimin e kufijve, doganën dhe shërbimet korrektuese, të cilat do të ushtrohen në emër të tij nga MEPSM-ja, siç parashihet me nenin 13 të kësaj zgjidhjeje, nëpërmjet modaliteteve që do të përcaktohen nga Këshilli i BE-së në përputhje me këtë zgjidhje:

- a. Autorizimin që të sigurojë zbatimin e duhur të hetimeve ndaj rasteve të krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike, krimeve ekonomike/financiare dhe krimeve të tjera të rënda sipas ligjit, duke përfshirë, kur konsiderohet e duhur, zbatimin e këtyre hetimeve nga hetues ndërkombëtarë që do të veprojnë së bashku me autoritetet e Kosovës apo në mënyrë të pavarur;
- b. Autorizimin që të sigurojë që rastet që janë përshkruar në nenin 2.3 a. të këtij Aneksi të ndiqen në mënyrë të duhur, duke përfshirë, kur është e nevojshme, sto të ndiqen nga prokurorë ndërkombëtarë që do të veprojnë së bashku me prokurorët e Kosovës apo në mënyrë të pavarur. Përzgjedhja e rasteve për prokurorë ndërkombëtar do të bazohet në kritere objektive dhe masat mbrojtëse procedurale, siç janë përcaktuar nga kryesuesi i MEPSM-së. Prokurorët ndërkombëtarë do të shërbejnë sipas legjislacionit të Kosovës;
- c. Autorizimin për të siguruar që rastet e përshkruara në nenin 2.3 a. të këtij Aneksi dhe rastet civile që kanë të bëjnë me pronësinë të gjykohen si duhet, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, këto të gjykohen nga gjyqtarët ndërkombëtarë që do të punojnë në mënyrë të pavarur apo në panele me gjyqtarë të Kosovës në gjykatën përkatëse që ka juridiksion mbi rastin e dhënë. Përzgjedhja e rasteve për gjykim ku përfshihen gjyqtarë ndërkombëtarë do të bazohet në kriteret objektive dhe masat mbrojtëse procedurale, siç janë përcaktuar nga kryesuesi i MEPSM-së. Gjyqtarët ndërkombëtarë do ta gëzojnë

pavarësinë e plotë në kryerjen e detyrave të tyre gjyqësore dhe do të shërbejnë në sistemin gjyqësor të Kosovës në pajtim me ligjin;

d. Përgjegjësinë për të siguruar që vendimet që mirren për rastet që janë përkthyer në nenin 2.3 a. të këtij Aneksi të zbatohen si duhet dhe sipas ligjit nga autoritetet kompetente të Kosovës;

e. Autorizimin për të marrë përgjegjësi të tjera në mënyrë të pavarur apo nën mbështetjen e autoriteteve kompetente të Kosovës për të garantuar ruajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendin publik dhe sigurinë;

f. Në konsultim me PCN-në dhe sipas nevojës, autorizimin për t'i kthyer për rishqyrtim apo për t'i anuluar vendimet operative që merren nga autoritetet kompetente të Kosovës për ta garantuar ruajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendin publik dhe sigurinë;

g. Autorizimin për të mbikëqyrur, për të udhëhequr dhe për të ofruar këshilla në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit. Autoritetet e Kosovës duhet t'i lehtësojnë përpjekjet e tilla dhe të ofrojnë qasje të menjëhershme dhe të plotë tek çdo vend, individ, veprimtari, procedurë, dokument apo çështje a ngjarje tjetër në Kosovë;

h. Autorizimin për ta siguruar zbatimin e efektshëm të kësaj zgjidhjeje përmes kryerjes së detyrave që i janë caktuar PSBE-së në pjesët tjera të kësaj zgjidhjeje;

i. Autorizimin për t'i emëruar anëtarët e personelit të MEPSM-së për t'i kryer detyrat që i janë caktuar MEPSM-së.

2.4 PCN-ja do ta mbikëqyrë zhvillimin e institucioneve civile të Kosovës, duke përfshirë kontrollin civil mbi institucionet e saja të sigurisë, pa paragjykuar përgjegjësitë e NATO-s dhe të PUN-së në zhvillimin e FSK-së dhe mbikëqyrjen e saj civile, siç parashihet me nenin 14.5 të kësaj zgjidhjeje.

2.5 PCN-ja do ta mbikëqyrë zhvillimin e Agjencisë vendore të sigurisë, siç është përcaktuar në Aneksin VIII të kësaj zgjidhjeje.

2.6 PCN-ja do të ketë autorizimin për krijimin e një mekanizmi për rishikimin e kompetencave të tij dhe të PSBE-së, pa paragjykuar privilegjet dhe imunitetet që i gëzon PCN-ja dhe PSBE-ja sipas kësaj zgjidhjeje.

Neni 3 Bashkërendimi me akterët ndërkombëtarë

3.1 Për të siguruar koherencë dhe efektivitet në angazhimin ndërkombëtar në Kosovë, PCN-ja do t'i themelojë mekanizmat e duhur për bashkërendimin e aktiviteteve të të gjithë akterëve ndërkombëtarë. Këta akterë do t'i mbështesin përpjekjet e tilla duke ia ofruar PCN-së informatat relevante për ushtrimin e funksioneve të tij.

3.2 Nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE-ja) kërkohet që edhe më tutje ta zhvillojë misionin e saj në Kosovë, përfshirë një prani

gjithëpërfshirëse në terren, në mënyrë që ta mbështesë zhvillimin demokratik të Kosovës dhe punën e PCN-së dhe të zyrës së tij. Rregullime të veçanta për një mbështetje të tillë nga OSBE-ja do të përcaktohen midis OSBE-së dhe PCN-së. Misioni i OSBE-së dhe personeli i tij do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e njëjta, ashtu siç janë përcaktuar në nenin 4.6 të këtij Aneksi. Kosova do të mundësojë ofrimin e ndihmës së duhur Misionit të OSBE-së, e nevojshme për kryerjen efektive dhe efikase të detyrave të tij duke përfshirë, sipas nevojës, edhe sigurimin e ndihmës logjistike dhe administrative.

3.3 Në përputhje me rolin e tij të bashkërendimit të përgjithshëm përkitazi me mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj zgjidhjeje, PCN-ja do ta kryesojë një komitet për bashkërendim që do të përbëhet nga Kryesuesi i Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare, Kryesuesi i MEPSM-së, Kryesuesi e Misionit të OSBE-së dhe, nëse ky komision konsideron se është e nevojshme, përfaqësues të organizatave të tjera që do t'i kontribuojnë zbatimit të kësaj zgjidhjeje.

Neni 4 Struktura/punësimi i personelit në Zyrën e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar

4.1 PCN-ja do të emërohet nga një Grup Drejtues Ndërkombëtar pas konsultimeve me BE-në. GDN-ja do ta kërkojë miratimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për këtë emërim. Në GDN do të marrin pjesë: Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, Komisioni Evropian dhe NATO-ja.

4.2 PCN-ja do t'i raportojë drejtpërdrejtë Grupit Drejtues Ndërkombëtar dhe do t'i kryesojë takimet e tij. Grupi Drejtues Ndërkombëtar do t'i ofrojë udhëzime PCN-së.

4.3 PCN-së do t'i ofrohet mbështetje nga stafi (Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN-ja), sipas nevojës, për t'i ndihmuar në kryerjen e funksioneve që janë paraparë me këtë zgjidhje.

4.4 PCN-ja ka të drejtë të themelojë çfarëdo pranie në terren që ai e konsideron të nevojshme për zbatimin e plotë të kësaj zgjidhjeje. PCN-ja do ta themelojë një zyrë në terren në Mitrovicë, e cila do të përqendrohet, në veçanti, në sferat e sigurisë/sundimit të ligjit, të lirisë së lëvizjes/kthimit, të drejtave pronësore/strehimit dhe të zhvillimit ekonomik.

4.5 Sipas ligjeve të Kosovës, PCN-ja, edhe në cilësinë e tij si PSBE, do të gëzojë, sipas nevojës, zotësi juridike për ushtrimin e plotë të funksioneve të tij, siç parashihet me këtë zgjidhje.

4.6 PCN-së, edhe në cilësinë e tij si PSBE, do t'i caktohen privilegjet dhe imunitetet vijuese:

- a. Kosova do t'ia ofrojë PCN-së dhe PSBE-së dhe objekteve të tij, arkivave dhe pronave të tjera, privilegjet dhe imunitetet e njëjta që i gëzon një mision diplomatik dhe objektet e tij, arkivat dhe pronat tjera sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike.

b. Kosova do t'ia ofrojë PCN-së, PSBE-së dhe anëtarëve profesionalë të stafit të tij si dhe familjeve të tyre, si dhe profesionistëve ndërkombëtarë të emëruar nga PCN-ja, në pajtim me autoritetin e tyre ashtu siç parashihet me këtë zgjidhje, privilegjet dhe imunitetet e njëjta që i gëzojnë agjentët diplomatikë dhe familjet e tyre sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike.

c. Kosova do t'ua ofrojë anëtarëve të tjerë të stafit të zyrës së PCN-së dhe PSBE-së dhe familjeve të tyre privilegjet dhe imunitetet e njëjta që i gëzojnë anëtarët e stafit administrativë dhe teknik dhe familjet e tyre sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike.

Neni 5 Shkurtimi dhe përfundimi i mandatit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar

5.1 Bazuar në rekomandimet e PCN-së, Grupi Drejtues Ndërkombëtar do t'i përcaktojë standardet për shqyrtimin periodik të mandatit të PCN-së dhe do të zhvillojë një shqyrtim të plotë të kompetencave të PCN-së, jo më vonë se dy vjet pas hyrjes së fuqi të kësaj zgjidhjeje, duke synuar zvogëlimin gradual të fushëveprimit të kompetencave të PCN-së dhe shpeshëtisë së intervenimeve të tij.

5.2 Mandati i PCN-së do të skadojë atëherë kur Grupi Drejtues Ndërkombëtar të konstatojë se Kosova i ka përmbushur kushtet e kësaj zgjidhjeje.

Neni 6 Bashkëpunimi

6.1 Autoritetet e Kosovës do të bashkëpunojnë plotësisht me PCN-në, edhe në cilësinë e tij si PSBE, dhe me organizatat dhe akterët tjerë ndërkombëtarë, me qëllim të zbatimit të suksesshëm të të gjitha aspekteve të kësaj zgjidhjeje. Mosbashkëpunimi nga ana e autoriteteve të Kosovës do të përbëjë shkelje të kushteve të kësaj zgjidhjeje, siç parashihet me nenin 2.1 të këtij Aneksi.

6.2 Autoritetet e Kosovës duhet ta mundësojnë ndihmën e nevojshme për PCN-në, në cilësinë e tij si PSBE, me qëllim të realizimit të suksesshëm të detyrave të tij, duke përfshirë, sipas nevojës, ofrimin e mbështetjes logjistike dhe administrative.

ANEKSI X
MISIONI EVROPIAN PËR POLITIKA TË SIGURISË DHE MBROJTJES
(MEPSM)

Neni 1 Mandati dhe kompetencat

1.1 MEPSM-ja, nën udhëheqjen e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (PSBE-së) do t'i ushtrojë kompetencat e PSBE-së, siç është përcaktuar në nenin 2.3 të Aneksit IX të kësaj zgjidhjeje.

1.2 Kryesuesi i MEPSM-së do ta marrë përsipër menaxhimin e operacioneve të përditshme të misionit.

1.3 MEPSM-së dhe personelit të tij do t'i ofrohen privilegjet dhe imunitetet e njëjta me ato që janë paraparë me nenin 4.6 të Aneksit IX të kësaj zgjidhjeje.

Neni 2 Struktura

2.1 Kryesuesi i MEPSM-së do të caktohet nga Këshilli i Unionit Evropian.

2.2 Kryesuesi i MEPSM-së mund të themelojë çfarëdo pranie që ai e konsideron të nevojshme, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal për sigurimin e jetësimit të plotë të elementeve të sundimit të ligjit që parashihen me këtë zgjidhjeje.

2.3 MEPSM-ja do ta ketë një zinxhir të unifikuar komandues.

Neni 3 Bashkëpunimi

3.1 Kosova do t'ia ofrojë MEPSM-së tërë ndihmën e nevojshme për realizimin efikas dhe të efektshëm të detyrave të tij, duke përfshirë, sipas nevojës, ofrimin e mbështetjes logjistike dhe administrative.

ANEKSI XI PRANIA USHTARAKE NDËRKOMBËTARE

Neni 1 Objektivat

1.1 Prania ushtarake ndërkombëtare (PUN-ja) do të jetë përgjegjëse për:

- a. Ofrimin e sigurisë nga rreziqet e jashtme për Kosovën, derisa institucionet e Kosovës të mund ta marrin përgjegjësinë;
- b. Ofrimin a një mjedisi të sigurt dhe të mbrojtur në tërë territorin e Kosovës, në ndërlidhje me PCN-në dhe nën mbështetjen e institucioneve të Kosovës, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës të mund ta marrin përgjegjësinë për detyrat e sigurisë që kryhen nga PUN-ja për secilin rast veçmas;
- c. Mbikëqyrjen dhe mbështetjen, me ndihmën e të tjerëve, në themelimin dhe trajnimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK-së); kjo do të përfshinte verifikimin e së kaluarës së pjesëtarëve të saj të mundur për ta siguruar profesionalizmin; përpjekjet për të siguruar përfaqësimin e duhur etnik dhe të drejtën e shqiptimit të sanksioneve për sjelljet e papërshtatshme të pjesëtarëve të FSK-së, në bashkërendim me PCN-në;
- d. Verifikimin e përputhshmërisë me aspektet ushtarake të sigurisë të parapara me këtë zgjidhje;
- e. Mbështetjen dhe bashkërendimin e afërt të aktiviteteve me PCN-në si dhe ofrimin e këshillave ushtarake PCN-së;
- f. Ofrimin e ndihmës dhe këshillave përkitazi me procesin e integritimit në strukturat euroatlantike.

1.2 Në varësi të mjeteve dhe aftësive dhe derisa detyrat të mund t'u lihen të tjerëve në kuadër të programeve për të cilat duhet arritur marrëveshje, PUN-ja do t'u ofrojë ndihmën vijuese autoriteteve lokale dhe PCN-së:

- a. Reagimin ndaj ekstremistëve të dhunshëm;
- b. Sigurimin e lirisë së lëvizjes;
- c. Mundësimin e kthimit të refugjatëve;
- d. Konfiskimin, ruajtjen dhe shkatërrimin e armëve pa leje;
- e. Mbrojtjen e lokacioneve të caktuara fetare dhe kulturore;
- f. Zhvillimin e detyrave të monitorimit të kufijve sipas nevojës dhe
- g. Ofrimin e mbështetjes bashkësisë ndërkombëtare dhe organizatave kyçe civile zbatuese, për çdo rast veçmas, në përmbushjen e mandateve të tyre përkatëse.

1.3 PUN-ja do të mbikëqyrë dhe monitorojë FSK-në dhe do të ketë autoritet ekzekutiv mbi të, derisa PUN-ja, në bashkërendim me PCN-në, të konstatojë se kjo forcë është e vetëqendrueshme dhe e aftë t'i kryej detyrat që i janë caktuar në përputhje me standardet ndërkombëtare.

1.4 PUN-ja, në konsultim me PCN-në dhe Kosovën, do të ketë pushtetin ekzekutiv mbi TMK-në, dhe do të vendosë për kohën e shpërbërjes së TMK-së, ashtu siç parashihet në nenin 6 të Aneksit VIII të kësaj zgjidhjeje.

1.5 Me Republikën e Serbisë PUN-ja do të vazhdojë të zbatojë praktikën e vendosur nga Komisioni i përbashkët aktual për implementim. Me kalimin e kohës, veprimtaritë e Komisionit të përbashkët për implementim do të bëhen pjesë e një Komisioni të përbashkët ushtarak të ri që do të përfshijë autoritetet nga Kosova dhe Serbia, në kuadër të të cilit do të trajtohen çështjet ushtarake dhe të sigurisë me interes të përbashkët.

1.6 PUN-ja në bashkërendim me PCN-në, do t'i përcaktojë masat për krijimin e mirëbesimit midis FSK-së dhe institucioneve të mbrojtjes të Serbisë.

1.7 Në planin afatgjatë, PUN-ja do të mbetet e angazhuar me FSK-në për të ofruar këshilla, nëpërmjet të cilave do të synohet integrimi i mëtejshëm i Kosovës në strukturat euroatlantike të sigurisë dhe përfshirja e elementeve nga kjo forcë e sigurisë në misionet e mandatuar ndërkombëtarisht.

1.8 PUN-ja do t'i zhvillojë operacionet e saja nën autorizimin e Këshillit Veriatlantik dhe do t'i nënshtrohet drejtimit dhe kontrollit politik të tij, nëpërmjet zinxhirit komandues të NATO-s. PUN-ja do të ketë zinxhir komandues të unifikuar.

1.9 NATO-ja do të mbështesë zhvillimin e strukturave dhe ekspertëve në Kosovë për të siguruar kontrollin dhe menaxhimin efektiv civil të FSK-së, veçanërisht në fushat e zhvillimit strategjik, planifikimin e forcës, menaxhimin e personelit, planifikimin, programimin dhe planifikimin e buxhetit (PPBS), planifikimin dhe prokurimin, në pajtim me nenin 2.4 të Aneksit IX të kësaj zgjidhjeje.

Neni 2 Pushteti dhe kompetencat

2.1 Në përmbushjen e përgjegjësisë së PUN-së, kryesuesi i PUN-së do ta ketë autoritetin, pa iu nënshtrohet ndërhyrjeve apo marrjes leje, që të bëjë çfarëdo që ai e konsideron të nevojshme apo të duhur, duke përfshirë përdorimin e forcës ushtarake, për ta mbrojtur PUN-në dhe personelin tjetër të caktuar dhe për t'i përmbushur përgjegjësitë e saja. Kryesuesi i PUN-së ushtron pushtetin suprem në zonën operative sa i përket interpretimit të atyre aspekteve të zgjidhjes që i referohen PUN-së.

2.2 PUN-ja do t'i ketë kompetencat vijuese:

- a. Të drejtën për t'i përmbushur përgjegjësitë e saja ashtu si e konsideron të duhur duke përfshirë përdorimin e forcës së nevojshme kurdo që kërkohet dhe pa iu nënshtrohet ndonjë sanksionimi, ndërhyrjeve apo nevojë për të marrë leje nga dikush tjetër;
- b. Të drejtën për të ushtruar liri të plotë dhe të papënguar të lëvizjes në tërë territorin e Kosovës në çdo mënyrë;
- c. Të drejtën për të rivënë kontrollin e menjëhershëm dhe të plotë ushtarak mbi hapësirën ajrore (apo pjesëve të saja), nëse kërkesat ushtarake e diktojnë këtë.

Kryesuesi i PUN-së duhet të sigurohet që Autoriteti i Aviacionit të Kosovës të informohet në tërësi për ndonjë vendim të tillë;

d. Të drejtën për të zhvilluar hetime në objektet dhe shërbimet që ndërlidhen me përmbushjen e detyrave të saja;

e. Të drejtën për ta aprovuar dhe mbikëqyrur, në bashkërendim me PCN-në, themelimin e të gjitha forcave jopolicore dhe atyre që lidhen me sigurinë që propozohen nga Kosova.

f. Të drejtën për të ndërmarrë veprime që i konsideron të duhura për ta mbështetur mandatin e saj në përputhje me këtë zgjidhje.

2.3 Kosova do t'ia ofrojë PUN-së statusin, privilegjet dhe imunitetet që tash i janë ofruar KFOR-it sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/47.

2.4 Në të gjitha rastet, autoritetet e PUN-së do të rishikohen dhe, pas konsultimeve me palët relevante dhe vendimit të Këshillit Veriatlantik, do të bëhen ndryshimet e duhura, për çdo rast veçmas, përderisa institucionet e Kosovës t'i zhvillojnë kapacitetet e tyre dhe t'i shtojnë kompetencat dhe përgjegjësitë.

ANEKSI XII AGJENDA LEGJISLATIVE

Neni 1 Legjislacioni që formalisht duhet të miratohet gjatë periudhës së tranzicionit

Kuvendi i Kosovës duhet t'i miratojë zyrtarisht ligjet e nevojshme për implementimin e kushteve të kësaj zgjidhjeje gjatë periudhës së tranzicionit prej 120 ditëve, të cilat duhet të konsiderohen si të miratuara nga Kuvendi dhe do të vihen në zbatim menjëherë ditën e parë pas përfundimit të periudhës së tranzicionit. Legjislacioni i tillë do të përfshijë ligjet vijuese ose ndryshimet në to por nuk do të kufizohet vetëm në:

1.1 Ligjin mbi zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale;

1.2 Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale;

1.3 Ligjin mbi kufijtë komunalë;

1.4 Ligjin mbi themelimin e zonave të mbrojtura;

1.5 Rregulloret e punës apo ndryshimet e nevojshme të tyre, që konsiderohen të nevojshme për përmbushjen e kushteve të kësaj zgjidhjeje me përfundimin e periudhës së tranzicionit, duke përfshirë, në veçanti, rregulloret e punës që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 2 Legjislacioni që formalisht duhet të miratohet gjatë ose pas periudhës së tranzicionit

Kuvendi i Kosovës mund të miratojë zyrtarisht ligje të tjera gjatë periudhës së tranzicionit për t'i përmbushur kushtet e kësaj zgjidhjeje, të cilët, nëse miratohen, do të konsiderohen si të miratuara nga Kuvendi dhe do të vihen në zbatim menjëherë ditën e parë pas periudhës së tranzicionit. Përndryshe, legjislacioni i tillë do të miratohet dhe do të konsiderohet si çështje parësore pas përfundimit të periudhës së tranzicionit dhe në këtë legjislacion do të përfshihen ligjet vijuese ose ndryshimet në to, por pa u kufizuar vetëm në këto:

2.1 Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre;

2.2 Legjislacioni mbi themelimin e Këshillit të Sigurimit të Kosovës;

2.3 Ligji mbi themelimin e Autoritetit të Aviacionit Civil;

2.4 Ndryshimet e Rregullores së Kuvendit për themelimin e Komisionit të Kuvendit për Mbikëqyrje të Sigurisë;

2.5 Legjislacioni mbi financat lokale;

2.6 Ligjet që kanë të bëjnë me ndarjen e kompetencave dhe çështjet tjera në sektorët vijues:

2.6.1 Arsimin;

2.6.2 Kujdesin shëndetësor;

2.7 Ligjin mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës;

2.8 Ligjin për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës;

2.9 Ligjin për shërbimin në Policinë e Kosovës;

2.10 Ligjin për themelimin e Agjencisë Vendore të Inteligjencës së Kosovës;

2.11 Ligjin për nënshtetësinë kosovare;

2.12 Ligjin për simbolet nacionale dhe festat zyrtare

2.13 Ligjin për kthimin e pronës